




Zgjedhjet - Izbori - Elections

Demokracia në Veprim  
Demokratija na Delu  
Democracy in Action

## Nuk ka zgjedhje të lira pa qëllime të mira

Raport i Vëzhgimit të Zgjedhjeve Lokale 2013



Shkurt, 2014

# *Raport i Vëzhgimit*

Zgjedhjet Lokale 2013

Nuk ka zgjedhje të lira pa qëllime të mira

**Prishtinë**  
**Shkurt, 2014**

Copyright ©2014. Demokracia në Veprim (DnV).

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen bujare të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), si dhe ambasadave britaneze dhe norvegjeze në Kosovë. Opinionet, të gjetura dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Demokracisë në Veprim dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorëve.

## PËRMBAJTJA

<b>Hyrje</b> .....	<b>5</b>
Metodologjia .....	6
<b>I. Korniza Ligjore e Zgjedhjeve</b> .....	<b>8</b>
Legjislacioni Primar .....	8
Legjislacioni Sekondar .....	9
Marrëveshjet politike me Serbinë .....	9
<b>II. Niveli i informimit të votuesve</b> .....	<b>9</b>
Informimi për zgjedhjet lokale.....	10
Njohuritë për procedurat e votimit .....	10
Informacionet rreth Vendvotimeve .....	11
Njohuritë për mekanizmin e ankesave.....	12
<b>III. Përgatitjet për Zgjedhjet Lokale</b> .....	<b>13</b>
Shpallja e Zgjedhjeve .....	13
Puna e KQZ-së.....	13
Funksionimi i KKZ-ve .....	15
Trajnimi i KVV-ve .....	16
Edukimi Votues.....	16
Ankesat Zgjedhore .....	17
<i>Gjobat për subjektet politike.....</i>	<i>18</i>
<b>IV. Vlerësimi i fushatës zgjedhore</b> .....	<b>19</b>
<b>V. Procesi i votimit</b> .....	<b>22</b>
Përbërja e KVV-ve .....	22
Hapja e vendvotimeve.....	23
<i>Prania e materialeve propaganduese .....</i>	<i>24</i>
<i>Trajtimi i materialit të ndjeshëm.....</i>	<i>25</i>
<i>(Mos)qasja për personat me aftësi të kufizuar .....</i>	<i>26</i>
Parregullsitë e zakonshme gjatë votimit .....	27
<i>Lista e votuesve .....</i>	<i>27</i>
<i>Votimi familjar .....</i>	<i>28</i>
<i>Përpyekjet për votim të dyfishtë .....</i>	<i>30</i>
<i>Fotografimi i votës së shënuar .....</i>	<i>30</i>
Incidentet gjatë procesit të votimit .....	31
Procesi i votimit në Veri.....	32

<i>Procesi i votimit para mesditës</i> .....	33
<i>Tensionet e votimit pasdite</i> .....	33
<i>Ndërprerja e procesit në Mitrovicën e Veriut</i> .....	34
<i>Rivotimi në Mitrovicën e Veriut</i> .....	34
Rivotimi in Zveçan .....	35
Rivotimi në Partesh.....	35
Procesi i numërimit.....	35
<i>Periudha e numërimit të votave</i> .....	36
<b>VI. Pjesëmarrja e votuesve</b> .....	<b>37</b>
Votat e pavlefshme.....	39
<b>VII. Rekomandimet</b> .....	<b>40</b>
A. Komisioni Qendror Zgjedhor.....	40
B. Komisionet Komunale Zgjedhore .....	41
C. Komisionet e Vendvotimeve .....	41
D. Subjektet Politike.....	42
E. Mekanizmat e Ankesave .....	42
F. Kuvendi i Kosovës.....	43

## Hyrje

Zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010 u pasuan me muaj të çrregullimeve politike në Kuvend, si dhe një vakum institucional në Qeveri dhe Presidencë. Subjektet politike dyshonin në rezultatet e zgjedhjeve dhe legjitimitetin e deputetëve të zgjedhur, që rrezikonte stabilitetin demokratik të vendit. Për gati tri vite, subjektet politike punuan në reformë zgjedhore por nuk arritën pajtim për çështjet kryesore të reformës gjë që qoj deri tek bllokimi i tërësishëm i procesit. Në draft-amendamentet për ligjin e zgjedhjeve të përgatitur nga komisioni parlamentar për reformë zgjedhore, u miratuan kryesisht ndryshime të vogla kozmetike dhe nuk u preken problemet më kyçe të procesit zgjedhor. Për më tepër, prokuroria e shtetit dhe gjykatat themelore nuk ishin edhe shumë efektive në gjykimin e rasteve të krimeve elektorale nga zgjedhjet e kaluara<sup>1</sup>.

Duke pas parasysh mungesën e progresit në adresimin e problemeve zgjedhore të vitit 2010, në veçanti, shoqëria civile dhe shumica e subjekteve politike, ishin të shqetësuar për organizimin e zgjedhjeve lokale. Pikërisht për këtë arsye, Demokracia në Veprim (DnV) filloi përgatitjet e duhura për mobilizim që të sigurojë që zgjedhjet lokale të caktuara për në fund të vitit 2013 të ishin të rregullta, të lira dhe të drejta. DnV u mobilizua për të vëzhguar të gjitha aspektet e këtyre zgjedhjeve duke përfshirë fushatën elektorale, mbulimin e procesit zgjedhor nga mediat, trupat menaxhues të zgjedhjeve, procesin e votimit dhe të numërimit në ditën e zgjedhjeve, rivotimet si dhe procesin e ankesave dhe parashtresave.

Kësaj radhe subjektet politike që garuan në zgjedhje, trupat menaxhues të zgjedhjeve, prokuroria, shoqëria civile si dhe akterët ndërkombëtar në Kosovë ishin shumë më vigjilent për të mënjanuar problemet që pasuan zgjedhjet e përgjithshme.

Përderisa kishte disa raste të parregullsive në procesin e votimit, kishte sfida dhe rivotime, veçanërisht në komunat e veriut ku zgjedhjet u organizuan për herë të parë nga institucionet e Kosovës, në përgjithësi procesi i votimit për zgjedhjet lokale ishte i lirë, i drejtë dhe demokratik. Vetë prezenca e prokurorëve në terren, të shoqëruar nga Policia e Kosovës, dhe përgjigjja e tyre e shpejt në vendvotimet ku u raportuan parregullësi, dërguan një mesazh të fortë tek keq-bërësit. Duhet cekur se kishte parregullsi të cilat nuk u adresuan në proces zgjedhor, megjithatë organeve të rendit u takon pjesërisht merita për suksesin e zgjedhjeve lokale të lira dhe të drejta, edhe pse Mitrovica e Veriut dhe Zveçani mund të jenë përjashtime këtu.

Lirisht mund të thuhet se edhe fushata zgjedhore ishte më e qetë dhe e civilizuar në krahasim me zgjedhjet paraprake, megjithëse në balotazh u shfaqën disa

---

<sup>1</sup> FES Prishtina (2012), Krimi i Organizuar në Procesin Zgjedhor.

raste të izoluara kur gjuha e fushatës përshkallëzoj në gjuhë urrejtjeje dhe fyese për kundër kandidatët.

Megjithatë, siç tregon edhe ky raport, institucionet kanë mjaft punë për të arritur standardet e zgjedhjeve të cilat priten nga qytetarët dhe shoqëria civile. Edukimi i votuesve dhe parandalimi i fletëvotimeve të pavlefshme mbesin sfida, sikurse edhe sigurimi i fshehtësisë së votës për secilin votues duke parandaluar votimin familjar dhe votimin me asistencë në mënyrë jo të rregullt. Qasja në qendra votimit për të gjithë votuesit, duke përfshirë votuesit me nevoja të veçanta, si dhe sigurimi i përfaqësimit gjinor në trupat administrues dhe menaxhues të zgjedhje janë gjithashtu fusha ku Kosova mund të përmirësohet në masë të madhe nëse konkretizohet vullneti i institucioneve.

Tashmë Kosova ka kaluar nëpër shtatë cikle zgjedhore, tri nga të cilat i ka organizuar vetë pa ndihmë të madhe ndërkombëtare. Në vitin 2013 kishte rastin të ishte më e përfshirë në menaxhimin e zgjedhjeve në territorin më të paqashtëm të vendit, në komunat më veriore të Kosovës. Prandaj, udhëheqësit e zgjedhur, administratorët zgjedhor, subjektet politike si dhe shoqëria civile duhet të marrin mësim nga përvoja e këtyre cikleve zgjedhore dhe të ecin përpara me më vullnet dhe dije më të madhe për përmirësimin e procesit zgjedhor. Ky raport është një bazë e mirë për të bërë pikërisht këtë.

## Metodologjia

Qëllimi i Demokracisë në Veprim është arritja e standardeve më të larta demokratike në procesin zgjedhor në Kosovë, si dhe promovimi i zgjedhjeve legjitime dhe demokratike. Sikurse në zgjedhjet paraprake, me shpalljen e zgjedhjeve nga Presidentja e vendit, Demokracia në Veprim mobilizoj rrjetin e saj të organizatave dhe vullnetarëve për të edukuar votuesit, vëzhguar fushatën zgjedhore, procesin e votimit dhe numërimin, si dhe monitorimin e ankesave dhe parashtrësive.

Të gjetura e këtij raporti janë rezultat i monitorimit të drejtpërdrejtë pesë-mujor dhe hulumtimeve të bëra mbi procesin zgjedhor. Fillimisht, Demokracia në Veprim, ka bërë një anketim me qytetarët më të drejtë vote mbi platformat politike, procesin e votimit, mekanizmat e anketimit dhe njohuritë për qendrat e tyre të votimit.

Pas shqyrtimit të mjeteve për monitorim të fushatës, 11 organizata që koordinojnë punën e rrjetit të DnV-së, kanë angazhuar 50 vëzhgues afatgjatë nga krejt Kosova për të vëzhguar fushatën zgjedhore të partive politike dhe për të raportuar nëse partitë politike janë duke ju përmbajtur Kodit të Mirësjelljes që ekziston me dispozita të veçanta brenda legjislacionit kosovar. Demokracia në Veprim, ka monitoruar fushatën një mujore të raundit të parë të zgjedhjeve të mbajtura me datën 3 nëntor dhe atë pesë ditore të raundit të dytë të zgjedhjeve të mbajtura e 01 dhjetor 2013, pasi që legjislacioni kosovar parasheh

mbajtjen e raundit të dytë në rastet kur asnjëri nga kandidatët nuk fiton 50% +1 të votave. Të gjeturat nga monitorimi i fushatës janë publikuar nga DnV-ja në fund të secilës javë së fushatës përmes konferencave dhe komunikatave për shtyp, ku në mes tjerave subjekteve politike u është bërë thirrje që të respektojnë Kodin e Mirësjelljes.

Procesi i votimit në ditën e zgjedhjeve është monitoruar nga 1.600 vëzhgues të angazhuar nga DnV përmes rrjetit të saj të organizatave në tërë Kosovën, përfshirë edhe komunat e veriut. Secili nga vëzhguesit ishte trajnuar për legjislacionin zgjedhor, vëzhgimin e procesit të votimit dhe numërimit, mbushja e drejtë e formularëve dhe mënyrën e raportimit në Qendrën e Thirrjeve të krijuar nga DnV për secilën ditë të zgjedhjeve. Shumica e informatave të paraqitura në këtë raport vijnë nga të dhënat e mbledhura nga vëzhguesit ditor. Me të njëjtën metodologji, DnV ka vëzhguar zgjedhjet e raundit të dytë, rivotimin në Mitrovicë të Veriut, Zveçan dhe Partesh.

Në ditën e zgjedhjeve në të dy raundet, DnV ka themeluar një Qendër të Thirrjeve me 100 vullnetarë të cilët tri herë gjatë ditës kanë komunikuar me vëzhguesit në vendvotime për të marrë informata për daljen e votuesve, procesin e votimit dhe parregullsitë eventuale që kanë kërkuar vëmendjen e duhur të autoriteteve. Pasi që të gjitha të dhënat e vëzhguesve janë futur në bazën e të dhënave, ato janë analizuar dhe është përgatitur ky raport për të paraqitur një pamje të përgjithshme të zgjedhjeve lokale.

Vëzhgimi i numërimit është pasuar me publikimin e rezultateve paraprake për kandidatët për kryetarë komunash për shtatë (7) komunat kryesore. Demokracia në Veprim ka paraqitur edhe 10 ankesa në Panelin Zgjedhore për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) bazuar në informatat e ofruara nga vëzhguesit e saj, sikurse edhe është monitoruar procesi i ankesave dhe parashtresave, duke regjistruar rastet që janë dërguar në PZAP dhe rastet e zgjidhura.



## I. Korniza Ligjore e Zgjedhjeve

### Legjislacioni Primar

Zgjedhjet Lokale të 3 nëntorit 2013 ishin zgjedhje të rregullta të përcaktuara sipas mandatit dhe afatit ligjor dhe kushtetues. Data e zgjedhjeve sipas kompetencave u shpall nga Presidentja e Republikës Atifete Jahjaga me 2 korrik 2013. Ky vendim u mor duke u bazuar në Nenin 4 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, si dhe në konsultim me partitë politike dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Sipas po këtij vendimi, udhëzohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Kosovës t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve lokale.

Para këtij vendimi kishte një kërkesë të disa subjekteve politike dhe shoqërisë civile që data e mbajtjes së zgjedhjeve të ishte fundi i shtatorit respektivisht java e parë e tetorit, por kjo nuk ndodhi për shkak që ky proces ndërli dhej me procesin e bisedimeve politike mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë.

Korniza ligjore në të cilën u mbështet dhe u administrua ky proces elektoral ishin Ligji mbi Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligji mbi zgjedhjet Lokale si dhe disa aktet e tjera të rëndësishme ligjore si: Ligji mbi Vetë-Qeverisjen Lokale dhe Ligji mbi Kufijtë Administrativ Komunal.

Duhet theksuar se zgjedhjet e 3 nëntorit 2013, u organizuan me legjislacionin e pa "reformuar", meqë subjektet politike nuk arritën konsensusin politik për ta ndryshuar legjislacionin zgjedhor, edhe pse këtë proces e kishin filluar në prill të vitit 2011, pas miratimit të Rezolutës në Kuvendin e Kosovës. Në këtë rezolutë ishin artikulluar qëndrimet e Kuvendit i cili mbështeste zotimet dhe afatet kohore të përmbajtura në Memorandumin e nënshkruar nga tre liderët politik z. Behgjet Pacolli, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi që kishin të bënin me nevojën për amendamentimin e Kushtetutës dhe legjislacionit zgjedhor. Afati i përfundimit të këtyre ndryshimeve ishte përcaktuar në jo më shumë se 12 muaj. Përkundër që tanimë po bëhen gati tri vite që nga fillimi i këtij procesi, lidhshipi i subjekteve politike nuk ka arritur që të ndërtoj konsensus për shumicën e çështjeve që janë shtruar si tema të rëndësishme që duhet reflektuar në reformën e legjislacionit zgjedhor.

Po ashtu, këto zgjedhje ishin të organizuara me Ligjin për Zgjedhje Lokal që ende zgjedh prijësit e listës së kandidatëve automatikisht me votat për subjektin politik, pra në mënyrë jo të barabartë me kandidatët tjerë. Neni 7.5 i këtij ligji thotë "Vota e hedhur për subjektin politik konsiderohet si votë për kandidatin e parë në listën e kandidatëve të subjektit politik." Ndërsa pjesa e dytë e këtij neni thotë "KQZ-ja siguron që fletëvotimi nuk e lejon votuesin të votojë njëkohësisht për subjektin politik dhe për kandidatin e parë në listën e kandidatëve të këtij subjekti politik." Kjo nuk është në vijë me Nenin 7.4 të po të njëjtit ligj që parasheh që votuesi të votojë për vetëm një subjekt politik dhe vetëm një kandidat të subjektit politik.

## Legjislacioni Sekondar

Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), si organ kushtetues ka në kompetencë të përgatisë, mbikëqyrë, drejtoj dhe verifikoj të gjitha veprimet, që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve dhe shpall rezultatet e tyre. Në zbatimin e këtij mandati KQZ edhe për zgjedhjet lokale 2013, ka miratuar një numër mjaft të madh të akteve që e plotësojnë legjislacionin primar. Aktet e tilla të miratuara nga KQZ ishin: vendimet, rregullat zgjedhore dhe udhëzimet administrative. Gjithashtu ky institucion me qëllim të mbarëvajtjes së procesit zgjedhor ka nënshkruar disa memorandume me institucione të rëndësishme në mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor.

Një prej rregullave më kryesore që KQZ ka hartuar dhe miratuar menjëherë pas shpalljes së zgjedhjeve lokale ishte Rregulla Nr. 09/2013 për Votimin, Numërimin në Vendvotim dhe Menaxhimin e Qendrës së Votimit. Kjo rregull detajon procedurat kryesore mbi votim dhe numërim të fletëvotimeve të cilat duhet të u përmbahen KVV-të dhe detajon rolin dhe përgjegjësit e menaxherëve të qendrave të votimit.

## Marrëveshjet politike me Serbinë

Një rëndësi të veçantë këtij procesi zgjedhor i ka dhënë pjesëmarrja në zgjedhje të komunave të veriut të Kosovës (Mitrovica e Veriut, Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku), në të cilat jetojnë me shumicë qytetarët serbë. Ky komunitet për 14 vite ka penguar shtrirjen e sovranitetit dhe integritetit të Kosovës. Pjesëmarrja në zgjedhje e këtyre komunave erdhi pasi u arrit marrëveshja me 19 prill 2013 mes Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, e cila ndër të tjera në pikën 12 parashihte organizimin e zgjedhjeve lokale edhe në komunat veriore të Kosovës nën lehtësimin e OSBE-së dhe në koordinim me ligjet e Kosovës dhe standardet ndërkombëtare.

## II. Niveli i informimit të votuesve

Gjatë fushatës zgjedhore, DnV-ja ka bërë një hulumtim të opinionit publik në nivel Kosove, me një mostër<sup>2</sup> reprezentative, për të gjetur nivelin e informimit të votuesve për zgjedhjet lokale 2013. Anketimi mbi informimin e votuesve ishte dizajnuar për të parë se sa informata mendojnë që kanë votuesit për zgjedhjet lokale, njohuri për procedurat e votimit, përfshirë mënyrën e votimit, si dhe nëse ata e dinë me siguri qendrën e tyre të votimit dhe njohuritë e tyre për mekanizmat e ankesave.

---

<sup>2</sup> Mostra n=3066 mbi-mostër në gjashtë komuna, e dizajnuar për të siguruar një mostër përfaqësuese për Kosovë n=1200, shtresëzuar në vendbanime (urbane/ rurale/terrene të banueshme), deri në nivel rruge bazuar në rastësi sistematike. Margjina e gabimit për një mostër n=1200 është 2,5% për interval besueshmërie në 95%.

## Informimi për zgjedhjet lokale

Të dhënat nga anketimi tregojnë që 17,5% e të anketuarve nuk mendonin që kishin njohuri të mjaftueshme për zgjedhjet lokale dhe kandidatët që garonin (dy javë para mbajtjes së zgjedhjeve) dhe 2,8% e këtij grupi të të anketuarve mendonin që nuk kanë fare informata për zgjedhjet lokale. Mungesa e informatave për zgjedhjet lokale ka qenë më shumë e pranishme në mesin e respondentëve femra, atyre rural dhe grup moshave 35-44 dhe 65 e më të vjetër. Më shumë se 1/5 e femrave mendonin që nuk kanë informata të mjaftueshme për zgjedhjet lokale që do të mbaheshin me 03 nëntor 2013.




Votuesit në mes të moshave 35-44 vjeçare kishin më së paku informata për zgjedhjet lokale nga të gjitha grup moshat tjerat, me 20,8% të tyre që mendonin se nuk kanë informata të mjaftueshme për zgjedhjet lokale. Në anën tjetër, 18,9% e votuesve mbi 65 vjeç mendonin që ishin mire të informuar për zgjedhjet lokale. Në mesin e grupit më të madh të votuesve të pare (mosha 18-24 vjeç), 16,2% mendonin që nuk janë mirë të informuar. Votuesit urban, për 2%, mendonin që ishin më të informuar sesa votuesit rural.

## Njohuritë për procedurat e votimit

Njohuria për procedurën e votimit është një nga informatat më të rëndësishme që një votues duhet të ketë në ditën e zgjedhjeve. Dokumentet që duhet paraqitur në vendvotim dhe mbushja e drejtë e fletëvotimit janë ato çfarë duhet të dijë secili votues që shkon për të votuar dhe organet e administrimit të zgjedhjeve, siç janë KQZ dhe KKZ-të, por edhe shoqëria civile, duhet të sigurohen që votuesit i kanë këto informata para se ata të shkojnë në qendër të votimit. Është bërë shumë rutinë që gjatë fushatës zgjedhore fokusi të vihet në vëzhgim të asaj se si sillen subjektet politike dhe kandidatët e tyre dhe se si të rregullohet një gjë e tillë, kështu që fushatat e informimit dhe edukimit të votuesve po janë shumë të varfra.

Dy javë para Ditës së Zgjedhjeve, rreth 14% e votuesve nuk kanë qenë të vetëdijshëm për procedurat e votimit. Votuesit që kanë votuar për herë të parë të grup-moshës 18-24 vjet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme are, kanë pasur më së paku njohuri për procesin e votimit, ngase rreth 16% e tyre nuk kanë ditur se s'i të votojnë. Një përqindje e ngjashme e femrave, 16% prej tyre kanë deklaruar që nuk i dinë procedurat e votimit. Votuesit në zonat rurale po ashtu kanë qenë më pak të vetëdijshëm se sa votuesit e zonave urbane me 2.5% diferencë.


Këto shifra janë një indikator i numrit të madh të fletëvotimeve të pavlefshme, (mbi 10%) e që janë deklaruar nga komisionerët e vendvotimeve me 3 nëntor, veçanërisht ato për zgjedhjet për kuvend komunal (shih faqen 27 të raportit për më shumë informata mbi fletëvotimet e pavlefshme).



### Informacionet rreth Qendrave të Votimit

Një pengesë në procesin e votimeve në të kaluarën, por që ka vazhduar edhe gjatë këtyre zgjedhjeve, ka qenë kthimi i votuesve nga qendrat e votimit për shkak se ata nuk kanë pasur të drejtë vote në qendrën ku janë paraqitur.

Votuesit i caktohet qendra e votimit përmes një sistemi të koduar (kodi-P për zonat më rurale dhe kodi-UD për zonat urbane), që ipet nga Ministria e Punëve të Brendshme në momentin e lëshimit të dokumentit personal/letërnjoftimit. Mungesa e një sistemi të kodifikuar të adresave është pjesërisht përgjegjëse për vendosjen e gabueshme të votuesve në qendrave të votimit më të afërta. Një auditim që i është bërë Ekstraktit të Regjistrimit Civil gjatë përgatitjeve për zgjedhjet e vitit 2010, e që




është realizuar nga IFES përmes një hulumtimi ka treguar arsye të ndryshme se pse 40% e qytetarëve nuk kanë jetuar më në adresat e listuara në këtë ekstrakt<sup>3</sup>.

Hulumtimi ynë ka treguar se një në dhjetë votues nuk kanë qenë të sigurt se ku është qendra e tyre e votimit. Shpërndarja e këtyre votuesve ka qenë gati e barabartë për qytetarët e zonave urbane dhe atyre rurale, megjithëse në zonat urbane kjo është vërejtur më shumë, ngase në ato rurale, në shumicën e rasteve është vetëm një qendër e votimit në afërsi. Më shumë se 13% e votuesve që kanë votuar për herë të parë (mosha 18-24) nuk e kanë ditur qendrën e tyre të votimit, dhe kjo kryesisht ka ndodhur për shkak se ata nuk kanë votuar më herët e rrjedhimisht nuk e kanë ditur qendrën e tyre. Siç mund të shihet në faqe 27 të këtij raporti (Lista e Votuesve) kanë qenë mbi 17,000 qytetarë që nuk janë lejuar të votojnë, për shkak se nuk janë drejtuar në qendrën e duhur të votimit. Kjo situatë, për të cilën KQZ duhet të angazhohet më shumë që ta përmirësoj, ka pasur si pasojë një numër të lartë të votimit me kusht, si dhe ka shkaktuar konfuzion dhe irritim në Ditën e Zgjedhjeve, pastaj ka krijuar vështirësi në informimin e qytetarëve përmes sistemit postar dhe ka afektuar edhe daljen e votuesve në zgjedhje.

## Njohuritë për mekanizmin e ankesave

Nëse një votues ka ndonjë ankesë rreth aktivitetit në vendvotim, ai/ajo mund të kërkoj nga Kryesuesit i Vendvotimit që ta regjistroj ankesën në Librin e Votimit apo nëse votuesi dëshiron mund të parashtrij ankesë në PZAP<sup>4</sup>. Përveç procedurave të votimit dhe të drejtave të votuesve, KQZ është e obliguar që të ndërmarr fushata për informimin e qytetarëve mbi mekanizmat e ankimimit<sup>5</sup>. Ligji e specifikon që votuesit në zona rurale si dhe ata me aftësi të kufizuara apo analfabet, duhet të jenë një cak i veçantë i fushatave vetdijësuese të KQZ-së.

Hulumtimi i realizuar në tetor, 2013, muajin e fushatës zgjedhore tregon që më shumë e gjysma e votuesve (51.1%) nuk kanë qenë të vetëdijshëm rreth mekanizmave të ankimimit. Rreth 56% e votuesve që kanë votuar për herë të parë, por edhe ata të zonave rurale dhe votueset femra me rreth 54.4% nga secili grup, kanë deklaruar që nuk kanë ditur për procedurat e ankimit.



<sup>3</sup> IFES. Janar 2011. Vlerësimi i Ekstraktit të Regjistrimit Civil, Tetor 2010. Shkruar nga Lauren Serpe.

<sup>4</sup> Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme. Neni 107c dhe Neni 94.

<sup>5</sup> Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme. Neni 107c dhe Neni 107.3.

### III. Përgatitjet për Zgjedhjet Lokale

#### Shpallja e Zgjedhjeve

Bazuar në kompetencat e dhëna me kushtetutë dhe në dispozitat ligjore përkatëse të ligjit për zgjedhjet lokale, me 02 korrik 2013, presidentja e vendit, znj. Atifete Jahjaga, ka caktuar datën e zgjedhjeve për me 03 nëntor 2013. Përkundër asaj që presidentja e vendit u takua paraprakisht me përfaqësues të partive politike, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe përfaqësues të shoqërisë civile për të marrë opinionin e tyre për datën më të favorshme për mbajtje të zgjedhjeve, shpallja e datës ishte peng i bisedimeve ndërmjet qeverisë së Kosovës dhe asaj të Serbisë.

Presidentja e vendit në njërin anë kishte kërkesën e disa subjekteve politike dhe të shoqërisë civile të cilët kërkonin që zgjedhjet të mbaheshin në vjeshtë e hershme. Kërkesa e tyre bazohej në eksperiencën e zgjedhjeve të vitit 2010 ku ishte dëshmuar që në orët e mbrëmjes kishin ndodhur parregullsitë më të mëdha zgjedhore, dhe në mundësinë që kushtet atmosferike në këtë kohë do të ishin më të mira dhe potencialisht pjesëmarrja në zgjedhje do të ishte më e lartë. Në ndërkohë, qeveria e Kosovës dhe ajo e Serbisë, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, vazhdonin bisedimet të cilat kishin për synim përfshirjen e komunave të veriut për herë të parë në një proces zgjedhor të organizuar nga institucionet vendore. E gjendur në një situatë të tillë, presidentja e vendit zgjodhi pritjen e rezultatit të bisedimeve ndërmjet dy vendeve dhe shpalli zgjedhjet për më datën 03 nëntor 2013. Përfshirja e komunave të veriut në procesin zgjedhor është një nga të arriturat më të mëdha që ka pasur Kosova pas shpalljes së pavarësisë, megjithatë, zhvillimet e mëvonshme treguan që ky proces ka qenë mjaft sfidues, sidomos për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) i cili është përballur me probleme të sfidave të ndryshme gjatë organizimit të zgjedhjeve në këtë pjesë të territorit të vendit.

#### Puna e KQZ-së


KQZ është organ i përhershëm kushtetues që përgatit, mbikëqyr dhe drejton të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor<sup>6</sup>. Zgjedhjet e vitit 2013 kanë qenë ndoshta më të vështirat në aspektin organizativ për KQZ-në sepse barra e negociatave ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka rënë edhe mbi këtë institucion. Si rrjedhojë, KQZ u shndërrua në një arenë debatesh të brendshme politike dhe shumë afate të parashtruara me planin operacional nuk u arritën me kohë. Prania ose jo e simboleve shtetërore në fletëvotime ishte një nga çështjet më të ndjeshme me të cilën u përballë KQZ. Në një mbledhje të tensionuar, e me propozim të përfaqësuesit të SLS-së në KQZ, u miratua dizajni i fletëvotimeve pa simbole të Republikës së Kosovës. Shumica e anëtarëve shqiptarë të KQZ-së abstenuan për këtë çështje, përderisa anëtari i Lëvizjes

---

<sup>6</sup>Kushtetuta e Kosovës. Neni 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve]

Vetëvendosje në momentin e votimit e lëshoj mbledhjen dhe nuk mori pjesë fare pjesë në votim.

Organizimi i zgjedhjeve në veri të vendit ishte sfida më e madhe e KQZ-së në këto zgjedhje. Përderisa një marrëveshje ishte arritur me OSBE-në për të lehtësuar organizimin e zgjedhjeve në këtë pjesë të vendit, ishte KQZ që formalisht do të duhej të merrte vendime edhe për këto komuna. Në këtë aspekt, KQZ u përballë me shumë probleme duke filluar nga nënshkrimi i deklaratave të kandidatëve e deri të nënshkrimi i kontratave të punës me zyrtarët komunal zgjedhor. Praktikisht, KQZ nuk kishte fare qasje në këtë pjesë të vendit dhe çdo aktivitet zgjedhor në këtë pjesë organizohej nga OSBE. Kjo e fundit jo rrallë herë u akuza nga anëtarët e KQZ-së për mungesë së transparencës dhe mos-informim të KQZ-së për punën që është duke bërë në atë pjesë të vendit. Përkundër kërkesës së anëtarëve të KQZ-së për raportim me shkrim nga ana e OSBE-së, për një kohë të gjatë kjo kërkesë nuk u realizua.



Përgjatë këtij procesi zgjedhor, KQZ-së i janë ndërruar tre anëtarë nga 11 gjithsejtë. Përfaqësuesi i Vetëvendosjes Alban Krasniqi u largua pasi që vendosi të garojë për kryetar të komunës së Malishevës. Z. Krasniqi u zëvendësua nga z. Adnan Rrustemi, i cili vetëm disa ditë më parë kishte dhënë dorëheqje nga pozita e zyrtarit të listës së

votuesve në S-QZ. AKR e shkarkojë përfaqësuesin e vetë, z. Fadil Maloku, me arsyetimin se ky i fundit ‘i ka humbur lidhjet me partinë’. Megjithatë, z. Maloku ka pretenduar se largimi i tij lidhet ekskluzivisht me kundërshtimin të tij për mos-heqje të simboleve shtetërore nga fletëvotimet. Në vend të z. Malokut, përfaqësues i AKR-së në KQZ është emëruar z. Nasuf Aliu.

Se KQZ nuk bënë dallim nga institucionet tjera publike të Kosovës kur është në pyetje punësimi pa plotësuar procedurat ligjore, tregon mënyra e kalimit e z. Goran Zdravković nga anëtar i KQZ-së (përfaqësues i SLS) në zv. Kryeshef të Sekretariatit të KQZ-së. Në këtë rast KQZ ka bërë disa shkelje, në të njëjtën mbledhje e ka miratuar dorëheqjen e z. Zdravković nga anëtar i KQZ-së dhe e ka emëruar atë në pozitën e zv. Kryeshefit të SKQZ-së. Skandali bëhet edhe më i madh kur dihet fakti që z. Zdravković ka qenë kryesues i panelit vlerësues të KQZ-së pikërisht për konkursin e shpallur nga KQZ për këtë pozitë, dhe e cila ishte anuluar disa herë nga KQZ. Kjo mund të rrit dyshimet që anulimi i këtij konkursi është bërë pikërisht me qëllimin që kjo pozitë t'i ruhet z. Zdravković. Z. Nenad Rikalo është emëruar anëtar i KQZ-së në vend të z. Zdravković.

Përfshirja e të gjitha komunave të Kosovës në proces të votimit, e bëri KQZ-në në disa raste pjesë të negociatave ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Kryetarja e KQZ-së, znj. Valdete Daka, ishte së paku një herë pjesë e delegacionit kosovar që ka qëndruar në Bruksel për negociata. Anëtarët e KQZ-së e konsideruan si të panevojshëm pjesëmarrjen e znj. Daka në negociata dhe kërkuan raport me shkrim për rolin që kishte znj. Daka në dialog.

Disa afata ligjore dhe aktivitete të parapara me planin operacional nuk u realizuan pikërisht për shkak të implikimeve që kishin negociatat ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, përkatësisht përfshirjes së të gjitha komunave në procesin zgjedhor. Qytetarëve nuk u është dhënë mundësia që fare të sfidojnë listën e votuesve, për shkak se afati i regjistrimit të votuesve jashtë vendit ishte shtyrë dy herë me qëllim të krijimit të mundësisë së regjistrimit të serbëve që jetojnë jashtë vendit. Për periudhën e sfidimit të listës së votuesve KQZ kishte realizuar edhe spote televizive dhe i kishte transmetuar, duke ftuar qytetarët që të sfidojnë listën e votuesve, përkundër asaj që praktikisht një gjë e tillë nuk u mundësohej.

Votimi me postë ishte një sfidë tjetër që përcolli administrimin e zgjedhjeve. Për votuesit serbë, edhe në këtë proces një rol të veçantë kishte OSBE e cila kishte marrë përsipër që të bënë transportin nga Serbia dhe Mali i Zi deri në KQZ. Afati për të aplikuar për votim me postë ishte shtyer dy herë nga KQZ në mënyrë që t'u mundësohej sa më shumë qytetarëve që të ushtrojnë të drejtën e votimit. Nga 41,168 aplikime të pranuar, 13,841 prej tyre ishin pranuar si të rregullta, edhe pse një pjesë e tyre vetëm pas ankesës së parashtruar në PZAP. Anëtarët e KQZ-së kishin akuzuar PZAP-në se kishte kaluar afatet ligjore për shqyrtim të ankesave të bëra pranë këtij institucioni.

## Funksionimi i KKZ-ve

Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ) janë organe dytësore të menaxhimit të procesit zgjedhor. Përderisa një zyrtar ekzekutiv i KKZ-së është i përhershëm, anëtarët tjerë të KKZ-ve emërohen 15 ditë pas shpalljes së zgjedhjeve nga presidenti i vendit. KKZ-të përbëhen nga shtatë (7) ose më shumë anëtarë, varësisht se sa parti kualifikohen për të qenë pjesë e komisionit<sup>7</sup>. Funksionimi i komisioneve komunale zgjedhore në zgjedhjet e vitit 2013 ka variuar nga komuna në komunë. Sipas vëzhguesve afatgjatë të Demokracisë në Veprim, ka pasur komuna ku KKZ-të kanë funksionuar në mënyrë të rregullt dhe kanë mbajtur takime të rregullta. Në anën tjetër ka pasur edhe komuna ku KKZ-të nuk kanë mbajtur fare takime të rregullta dhe bartja e mesazheve tek anëtarët e KKZ-ve, rrjedhimisht edhe tek partitë politike, është bërë përmes SMS-ve ose thirrjeve telefonike. Vëzhguesit në terren të Demokracisë në Veprim nuk kanë arritur që të sigurojnë asnjë procesverbal të mbledhjeve të KKZ-ve. Në anën

---

<sup>7</sup>Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme. Neni 67 [Përbërja e KKZ-ve dhe Kualifikim i Anëtarëve]



tjetër, në njëërën nga mbledhjet e KQZ-së, anëtarët e KQZ-së kanë përmendur faktin se në disa komuna KKZ-të punojnë në kushte të rënda teknike gjë që është vërtetuar edhe nga vëzhguesit në terren të Demokracisë në Veprim.

Legjislacioni i ardhshëm zgjedhor duhet të trajtojë në mënyrë më të detajshme çështjen e funksionimit të KKZ-ve dhe funksionimi i tyre të jetë uniform në të gjitha komunat, e jo të lihen në varësi të Zyrtarit Ekzekutiv Zgjedhor.

## Trajnimi i KVV-ve

Duke pasur parasysh rolin që kanë komisionerët e zgjedhjeve në mbarëvatjen e procesit zgjedhor, Demokracia në Veprim i ka kushtuar rëndësi të veçantë monitorimit të procesit të trajnimeve për komisionerë. Demokracia në Veprim ka monitoruar një numër të konsideruar të trajnimeve të organizuara nga KQZ. Përderisa përmbajtja e trajnimeve ka qenë në nivel relativisht të lartë, pjesëmarrja e komisionerëve në këto trajnime ka lënë shumë për të dëshiruar. Natyrisht që në këtë aspekt faji kryesor i përket partive politike të cilat nominojnë përfaqësuesit e tyre si komisionerë. Megjithatë, KQZ do të duhej të gjente forma që të ndëshkonte ata që nuk ndjekin trajnimet dhe të mos u mundësonin atyre që nuk ndjekin trajnimet që të ushtrojnë rolin e komisionerit në ditën e zgjedhjeve.

Fatkeqësisht, sipas raporteve të vëzhguesve të Demokracisë në Veprim, një numër shumë i madh i komisionerëve nuk i kanë ndjekur trajnimet e organizuara nga KQZ. Një gjë e tillë u dëshmuar edhe gjatë ditës së zgjedhjeve kur në një numër të konsideruar të vendvotimeve, komisionerët nuk kishin njohuri si për procedurat e votimit ashtu edhe për ato të numërimit të votave. Ka indikacione që një numër i konsiderueshëm i fletëvotimeve të parregullta ka ardhur si rezultat i mosnjohurive të komisionerëve se kur duhet të shpallet një votë e pavlefshme. P.sh., në disa vendvotime komisionerët i kanë shpallur të pavlefshme edhe votat kur votuesi ka shënjuar subjektin politik si dhe më shumë se një kandidat nga lista e kandidatëve, e që normalisht kjo votë i shkon vetëm subjektit por nuk mund të shpallet e pavlefshme.

KQZ do të duhej të krijonte një listë të zezë të komisionerëve të cilët nuk kanë vijuar trajnimet në zgjedhjet e kaluar dhe të njëjtëve t'u mohojë nominimi nga partitë politike për të qenë komisionerë në zgjedhjet e ardhshme.

Vlenë të theksohet se edhe doracaku i trajnimeve nuk ka qenë mjaftë i qartë dhe i kanë munguar shembujt ilustrues përmes fotografive dhe skicave e që janë të domosdoshme për të kuptuar procedurat e votimit dhe të numërimit të votave.

## Edukimi Votues

Fushata e Informimit Publik të Votuesve e organizuar nga KQZ ka qenë ndër më të dobëtat që KQZ ka organizuar ndonjëherë. Strategjia e Informimit Publik e miratuar nga KQZ nuk ka arritur që të pëmbushet në masën më të madhe të saj, dhe këtë për disa arsye, ku më kryesorja është mungesa e kapaciteteve brenda

KQZ-së për të të menaxhuar një fushatë të informimit publik, dhe e dyta kufizimi që e ka KQZ me procedurat e tenderimit. Edhe Këshilli Mbikëqyrës për zbatimin e kësaj strategjie i themeluar nga KQZ nuk e bëri punën e tij si duhet, duke mos kërkuar në vazhdimësi përgjegjësi për zbatimin e strategjisë.

Natyrisht që një pjesë e fajit se pse akoma kemi një numër të madh të votave të pavlefshme është pikërisht mungesa e edukimit të mirëfilltë të votuesve, si nga KQZ, po ashtu edhe nga partitë politike, por edhe nga organizatat e shoqërisë civile. Po ashtu, numri i madh i votuesve që nuk e gjejnë emrin në listën e votuesve gjatë ditës së zgjedhjeve dhe numri i madh i personave të vdekur në lista të votuesve, pjesërisht mund t'i atribuohen edhe mungesës së informimit dhe edukimit të votuesve. Përderisa penetrimi i internetit në Kosovë është shumë i lartë, KQZ nuk i ka kushtuar vëmendje plasimit të informatave për votues në faqen e saj zyrtare në internet. Asnjë nga materialt edukuese/informative për votuesit, nuk është në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së, qofshin ato broshura informative, spote apo informata tjera me rëndësi për votuesit.

## Ankesat Zgjedhore

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka qenë mjaft i angazhuar gjatë periudhës zgjedhore. Krahas shqyrtimit të ankesave të subjekteve politike, PZAP u angazhua edhe në shqyrtimin e 16,535 ankesave të qytetarëve serbë të cilëve KQZ fillimisht u refuzojë aplikimin e votimit përmes postës.

Sipas të dhënave të PZAP<sup>8</sup> numri i ankesave të parashtruara nga të gjitha palët e interesuara në të dy raundet e zgjedhjeve ka qenë 1.064 ankesa dhe 45 apele. Numri më i madh i ankesave është parashtruar nga kandidatët për kuvend komunale, gjithësejt 488. Ky numër kaq i madh i ankesave nga kandidatët për kuvende komunale ngre edhe një herë dyshimet për manipulimet e votave brenda subjekteve politike.

Nga subjektet politike, Lëvizja Vetëvendosje ka parashtruar më së shumti ankesa, 155, pasuar nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) 127, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) 84 ankesa dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës 40 ankesa. Nga organizatat e shoqërisë civile, Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) kishte parashtruar 27 ankesa dhe Instituti Demokratik i Kosovës në emër të Demokracisë në Veprim 10 ankesa.

Shumica absolute e ankesave të dërguara në PZAP u refuzuan, shumica nga to me arsyetimin se janë të pabazuara në fakte (588 ankesa dhe 8 apele) dhe si të palejuara (247 ankesa dhe 34 apele). Megjithatë, PZAP ka miratuar edhe një

---

<sup>8</sup>Demokracia në Veprim falenderon zyrtarët e PZAP-së të cilët kanë qenë shumë bashkëpunues dhe kanë ofruar të dhënat e kërkuara si gjatë procesit të fushatës zgjedhore, para dhe pas procesit zgjedhor.

numër të madh të ankesave e që kanë rezultuar me gjoba të partive politike (109), rivotim një (1) dhe rinumërim 21.

### **Gjobat për subjektet politike**

Total i gjobave të shqiptuara nga PZAP për subjektet politike është 184,500 euro, prej të cilave deri në janar të vitit 2014 janë paguar vetëm 2,600 euro, përkundër asaj që subjektet politike janë të detyruara që pagesën e gjobave t'a bëjnë brenda 15 ditëve nga data e shqiptimit. Gjoba më e lartë e shqiptuar nga PZAP ka qenë 5,500 euro, përderisa ajo më e vlogla 200 euro.

Subjekti që më së shumti është dënuar nga PZAP është Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me 91,050 euro, gati gjysma e totalit të shumës së gjobave të shqiptuara nga PZAP. Subjekti i dytë të cilit PZAP i ka shqiptuar gjobat më të larta është AAK me 37,650 euro, LDK 32,850 euro, AKR 11,900 euro dhe VV 1250 euro. Përveç Lëvizjes Vetëvendosje e cila ka mbetur pa paguar edhe 450 euro, asnjëra nga subjektet e mëdha nuk ka paguar akoma asnjë nga gjobat e shqiptuara.

Sipas të dhënave të PZAP, numri më i madh i ankesave të paraqitura nga subjektet politike i referohen nenit 33 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme e që lidhen me fushatën zyrtare zgjedhore, siç janë heqje, mbulim, dëmtim ose ndryshim i ndonjë njoftimi, pllakati, posterit ose materiali tjetër që përdoret gjatë fushatës zgjedhore, si dhe vendosja e njoftimeve pllakateve dhe posterave me emrat e kandidatëve apo të sloganeve të subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike etj.

## IV. Vlerësimi i fushatës zgjedhore

Fushata zgjedhore për vitin 2013, zyrtarisht ka filluar me 3 tetor dhe ka mbaruar me heshtjen zgjedhore me datë 2 nëntor, 24 orë para Ditës së Zgjedhjeve. Kjo është qartazi e definuar në Nenin 3 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme. Periudha e fushatës zgjedhore për raundin e dytë është vendosur nga KQZ-ja, që të zgjas vetëm 5 ditë, duke filluar nga 25 e deri me 29 nëntor.

DnV ka pasur 50 vëzhgues afatgjatë që kanë vëzhguar fushatën zgjedhore dhe takimet e të gjitha subjekteve politike në të gjitha komunat e Kosovës, si dhe takimet e Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ) që janë përgjegjëse për aspektet logjistike të organizimit të zgjedhjeve në komunat e tyre. DnV, ka monitoruar gjithsej 851 takime para-zgjedhore dhe ka raportuar rreth tyre, e po ashtu ka monitoruar edhe 42 takime para-zgjedhore të balotazhit. Prej këtyre, 225 kanë qenë takime të PDK-së, 197 të LDK-së, 142 të AAK-së, 110 të VV-së dhe 58 të AKR-së.

Ligji parasheh që fushata zgjedhore të organizohet në atmosferë paqësore, pa shfrytëzim të fondeve dhe resurseve publike nga zyrtarët publik për qëllime të përfitimit të votës apo mbështetjes në asnjë mënyrë. Për më shumë, ligji ua ndalon partive politike shfrytëzimin e shërbyesve civil për të bërë fushatë në emër të partive apo për të marr pjesë të drejtpërdrejt në fushatë<sup>9</sup>.

Përgjithësisht, fushata zgjedhore ka qenë paqësore dhe pa asnjë incident serioz, me përjashtim të problemeve në pjesën veriore të vendit. Për këtë çështje, DnV përmes një komunikatë për shtyp ka dënuar incidentet në veri dhe ka kërkuar nga autoritetet përgjegjëse që ofrojnë sigurinë e nevojshme për zhvillimin e një procesi normal zgjedhor. Sulmi në shtëpinë e njërit nga kandidatët kryesor për kryetar të komunës së Mitrovicës së Veriut dhe incidentet e shkaktuara në takimet parazgjedhore, kryesisht nga personat që kanë kandiduar kundër partisë së themeluar rishtazi, GIS (Iniciativa Lista Serbe), kanë qenë shumë shqetësuese dhe kanë ngritur tensione, gjë që ka mund të luaj një rol negativ në kërcënimin e votuesve. Ka pasur shumë raste kur shërbyesit civil janë thirrur në fushata zgjedhore, veçanërisht nga PDK në Ferizaj dhe Mitrovicë.

Për më shumë, ligji ua ndalon partive politike, kandidatëve dhe përkrahësve të tyre, që të mbajnë apo shfaqin armë në çfarëdo takimi publik, që të pengojnë gazetarët në kryerjen e detyrave të tyre dhe për tu premtuar shpërblime financiare me qëllimin marrjen e përkrahjes së votuesve<sup>10</sup>.

Prandaj, përveç atmosferës së përgjithshme të fushatës zgjedhore, vëzhguesit e DnV-së kanë regjistruar raste të përdorimit të resurseve publike nga kandidatët për qëllime të fushatës zgjedhore, prezencës së personave të armatosur në takime, të parandalimit të mediave në kryerjen e punës së tyre, siç e rregullon

<sup>9</sup> Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme. Neni 34.3, Neni 35.1 dhe Neni 35.2.

<sup>10</sup> Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme. Neni 33.


ligji por edhe prezencë të fëmijëve në takime të fushatës. DnV konsideron që pjesëmarrja e fëmijëve në fushatë zgjedhore (mbi 5%) është e papranueshme. Grupe të shumta fëmijësh në fushata zgjedhore kanë qenë prezent në një në çdo shtatë takime publike të LDK-së, AAK-së, AAK-së dhe PDK-së. Përderisa, VV dhe AKR, kanë pasur 5%, respektivisht 8% prej publikut prezent e që kanë qenë fëmijë. Resurset publike janë përdorur më shumë nga zyrtarët e PDK-së, në 30 takime apo në 13% të të gjitha takimeve të PDK që janë vëzhguar. Kandidatët e AAK-së, veçanërisht kandidati i saj në Deçan, ka përdorur burimet publike, në së paku tri (3) raste të fushatës. Partia në pushtet në nivel qendror, PDK, sikur edhe në fushatat e kaluara zgjedhore ka premtuar fonde të mëdha, me shifra specifike, për komuna të ndryshme në rast se PDK do të fitojë, e që mund të konsiderohet shkelje e Nenit 33, paragrafi f.

Në balotazh, fushata ka filluar dhe mbaruar me tone më agresive të përdorua nga kandidatët dhe subjektet politike, veçanërisht nëse krahasohen me raundin e parë të zgjedhjeve. Kandidatët në balotazh kanë garuar vetëm kundër një kundërshtari, dhe veçanërisht në komunat e mëdha, situata ka qenë më e ashpër dhe e tensionuar.


Të dhënat zyrtare të ofruara nga PZAP, tregojnë që në javën e dytë të fushatës, 78 ankesa janë parashtruar nga subjektet politike. Sipas të dhënave të njëjta, një numër i madh ankesash është parashtruar nga LDK me gjithsejtë 28 ankesa, e ndjekur nga VV me 27, PDK me 19, Unioni Demokratik me 3 dhe SLS me një ankesë. Subjekti politik ndaj të cilit janë parashtruar më së shumti ankesa ka qenë PDK me 37 ankesa kundër saj, LDK me 17, AAK me 13 dhe VV me 1 ankesë kundër saj. Përgjithësisht, 29 ankesa janë parashtruar rreth posterave në ndërtesa publike, 17 raste për vendosjen e posterëve në shenja të trafikut, 8 për vendosjen e posterëve në rrugë dhe 5 ankesa për mbulimin e posterave.

Disa kandidatë për Kryetar komune kanë filluar fushatën zgjedhore para datës zgjedhore. Mungesa e parashikimit të dënimeve rreth fillimit zyrtar të fushatës ua ka lehtësuar partive politike fillimin e mëhershëm të fushatës. Ky cikël zgjedhor, është shoqëruar me një ndryshim të metodologjisë së bërjes së fushatës zgjedhore, ngase përveç takimeve publike, partitë kanë realizuar edhe takime “derë më derë”, duke komunikuar kështu drejtpërsëdrejti me qytetarët. Ky fenomen është vërejtur në të gjithë Kosovën.


**Tubimet e PDK-së**




**Tubimet e LDK-së**




**Tubimet e VVI-së**



**Tubimet e AAK-së**



**Tubimet e AKR-së**



**Figura 1: Raportimi nga tubimet e fushatës të subjekteve politike.**

## V. Procesi i votimit

### Përbërja e KVV-ve

Në përgatitjet për Zgjedhjet Lokale 2013, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kishte vendosur që të kishte 2.366 vendvotime në 796 qendra votimi në 38 komuna në Kosovë, duke përfshirë edhe Komunën e re të Mitrovicës së Veriut. Këtë radhë, kishte 58 qendra votimi shtesë, të vendosura kryesisht në shkolla publike, në krahasim me zgjedhjet e fundit të mbajtura në vitin 2010 dhe kjo kryesisht ishte bërë për të akomoduar më shumë se 150.000 votues të ri me të drejtë vote.


Për administrimin e këtyre 2,366 vendvotimeve, KQZ akreditoi 17,499 komisionerë në vendvotime nga subjektet politike, dhe 1,633 ishin komisionerë rezervë. Komisionerët ishin caktuar nga subjektet politike sipas Nenit 74.1 të ligjit i cili thotë se “përbërja e Këshillit të Vendvotimit (KVV) reflekton strukturën e anëtarëve të KKZ-së.” Numri i KKZ-ve përcaktohet me Nenin 67.1 të ligjit i cili thotë se KKZ në përgjithësi ka shtatë (7) anëtarë dhe ky numër mund të rritet. Megjithatë, numri mesatar i KVV-ve të emëruar për një vendvotim ishte 6.0

Komisionerë në Vendvotimeve				
Subjekti Politik	Anëtarë	Kryesues	Rezervë	Gjithsej
PDK	1,723	556	238	2,517
LDK	1,708	555	242	2,505
AAKLDD	1,707	548	239	2,494
AKR	2,000	0	188	2,188
LVV	1,702	528	216	2,446
GI Srpska	160	24	21	205
SLS	160	81	25	226
VAKAT	232	14	23	269
KDTP	545	1	56	602
PAI	15	3	4	22

**Tabela 1: Nr. i komisionerëve të vendvotimeve për subjektet politike kryesore.**

Shqetësuese për Demokracinë në Veprim ka qenë pjesëmarrja e ulët e grave në KVV. DnV ka përkrahur, për disa kohë tani, përfshirjen e grave në administrimin e zgjedhjeve pasi që kjo do të inkurajonte pjesëmarrjen e grave në zgjedhje. Subjektet politike kanë përgjegjësinë më të madhe në rekrutimin e grave për pozitat e tilla. Gjatë analizimit të dy komunave në vërejtëm, që në rastin më të mirë, në komunën e Prishtinës, vetëm 18% e KVV-ve të emëruar nga subjektet politike ishin gra, megjithatë, ishte inkurajuese që më shumë se 32% e grave kanë qenë Kryesuese të KVV-ve. Megjithatë, nëse shikojmë një komunë sikurse Deçani, gratë në KVV dhe Kryesueset e KVV-ve ishin përfaqësuar me vetëm 13%, përkatësisht 12%. Për fat të keq, shumica e komunave kishin numra më të përafërt me Deçanin sesa me Prishtinën.

## Përfaqësimi në KVV



### Hapja e vendotimeve

Vonesa apo mos-hapja e plotë e një vendvotimi është një nga problemet më të mëdha të një procesi zgjedhor. Sipas dispozitës ligjore të ligjit relevant, Neni 88.1 Qendrat e votimit hapen në orën 7:00 dhe mbyllen në orën 19:00. Kjo për ne do të thotë që të gjitha vendvotimet në qendrën e votimit duhet të jenë të hapura për votim.

Edhe këto zgjedhje u sfiduan me disa vendvotime që kishin vonesa të hapjes me kohë siç përcaktohet me ligj. Arsyeja për këtë vonesë mund të ketë qenë mungesa e materialit të nevojshëm zgjedhor apo kompletimi i Këshillit të Vendvotimit.

Vonesa në hapjen e vendvotimit mund të justifikohet për 5 deri në 10 min, dhe të tilla ishin rastet në shumë qendra votimi (rreth 1,069 të identifikuar nga vëzhguesit e DnV-së). Megjithatë, vonesat nga gjysmë ore e më shumë konsiderohen vonesa serioze në hapjen e një vendvotimi.

Vonesa në hapjen e 13 vendvotimeve ishte shqetësuese në raundin e parë të zgjedhjeve më 3 nëntor 2013. Megjithëse në orët e para pjesëmarrja është e ulët, prapëseprapë vonesat e hapjes shkaktuan pritje të votuesve në vendvotim për të hedhur votën e tyre. Në 9 vendvotime që nuk u hapen me kohë, vonesat shkuan përtej orës 8 në mëngjes. Ndërkohë, në raundin e dytë, dy vendvotime nuk u hapën me kohë; njëri në Mitrovicë dhe tjetri në Obiliq.

Raportet nga vëzhguesit tanë tregojnë që të gjitha rastet e këtyre vonesave, në raundin e parë, ishin në rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt. Në Komunën e Ferizajt ishin pesë (5) vendvotime që nuk u hapen me kohë, gjithashtu në Komunën e Gjilanit iishin pesë (5) raste kur vendvotimet nuk u hapen me kohë. Kaçaniku, Shtimja dhe Vitia kishin secila nga një vonesë prej një ore në hapjen e vendvotimit.




## Prania e materialeve propaganduese

Sipas ligjit, çdo personi, votuesi, komisioneri apo anëtar i një subjekti politik i ndalohet që të bëjë fushatë apo të shfaqë çfarëdo materiali me qëllim të ndikimit tek votuesi, jo vetëm në vendvotime por gjithashtu edhe 100 metra brenda hapësirës së njëjtë<sup>11</sup>.

Për më tepër, çdo anëtar i KVV-së, pavarësisht nga përkatësia e partisë politike ose pikëpamja politike, vepron në mënyrë të paanshme<sup>12</sup>.

Megjithatë, në bazë të raporteve të vëzhguesve të DnV-së, në 8% të vendvotimeve u raportua propaganda politike ose në vendvotim ose brenda rrethit prej 100m të qendrës së votimit. Në komunat ku ka pasur balotazh, kishte më pak raste të raportimit të propagandës politike jashtë qendrave të votimit por brenda vendvotimeve niveli i propagandës ishte ende i lartë dhe në disa komuna të caktuara propaganda politike u intensifikua. Në komunat e Gjakovës, Ferizajt, Gjilanit dhe Prizrenit të dhënat tona nga vëzhguesit tregojnë që kishte nivel më të lartë të propagandës brenda qendrave të votimit gjatë balotazhit, në krahasim me raundin e parë. Vëzhguesit tanë në Gjakovë regjistruan propagandë politike në shtatë qendra votimi në raundin e parë, kurse në balotazh propaganda politike u regjistrua në 13 qendra votimi.



Propaganda politike brenda vendvotimeve varionte në forma të ndryshme siç u regjistrua nga vëzhguesit e DnV-së. Në shkollën Mazllum Këpuska në Gjakovë, VV 02R, një nga emrat e kandidatëve ishte rrethuar në Librin e Kandidatëve, që mund të konsiderohet si fushatë për një kandidat të veçantë. Në Zahaq të Pejës, në shkollën Haxhi Zeka, VV 04R<sup>13</sup>, vëzhguesit e AAK-së bënë presion tek votuesit për të votuar për AAK-në duke ju folur atyre lidhur me kandidatin. Në qendrën e votimit në Tërstenik, Pejë (1710), një anëtar i PDK-së endej përreth klasave të shkollës duke bërë fushatë derisa menaxheri e largoi atë nga qendra. Në Dushanovë, Prizren, vendvotimi 03R, kishte fletushka të kandidatit të LDK-së në klasë. Në Fakultetin Teknik të Prishtinës, VV 01, komisioneri gjithmonë debatonte politikisht gjatë procesit të votimit.

<sup>11</sup> Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 36.1.

<sup>12</sup> Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 74.9.


<sup>13</sup> Zgjedhjet e balotazhit.

Ndërkohë, propaganda politike jashtë qendrave të votimit përbëhej kryesisht nga posterë dhe pankarta të subjekteve politike që nuk ishin hequr 24 orë para ditës së votimit siç kërkohet nga ligji për vetë kandidatët që bëjnë fushatë jashtë qendrave të votimit, sikurse ishte rasti me kandidatin e LDK-së për kryetar të Gjilanit në Përlepnice, Gjilan 0423D.

### Trajtimi i materialit të ndjeshëm

Një operacion i mirë i votimit varet shumë nga materiali i ndjeshëm dhe ai jo i ndjeshëm. Në zgjedhjet e vitit 2010, materiali i ndjeshëm, sidomos llambat ultraviolette dhe ngjyra spërkatëse për gisht ishin një problem i përhapur në të gjithë Kosovën. DnV ka raportuar që 10.7% e vendvotimeve në raundin e parë të zgjedhjeve nacionale në vitin 2010 kishin probleme me llambat ultraviolette dhe me ngjyrë. Në zgjedhjet lokale 2013, ky problem u zgjidh, edhe pse kishte vendvotime që u mungonin këto materiale.

Mungesa e fletëvotimeve që u vërejt në raundin e parë të zgjedhjeve në 21 vendvotime, ishte më shumë pasojë e vendimit të KQZ-së që këshillonte vendvotimet të kishin 10% më pak fletëvotime se persona me të drejtë vote në listën e votimit në atë vendvotim. Ky vendim në parim dukej i qëlluar duke pasur parasysh se konsiderohet që edhe lista e votuesve po ashtu përmban njerëz që jetojnë në diasporë apo emra të personave të vdekur (shih faqen 30 për më shumë detaje).



Numri i llambave UV nuk ishte i mjaftueshëm apo konsiderohej si jo funksional në 18 vendvotime në raundin e parë, gjersa kjo u vërejt në gjashtë (6) vendvotime në raundin e dytë të zgjedhjeve. Në krahasim me numrin e përgjithshëm prej 2.366 vendvotimeve, ky numër konsiderohej si i ulët, mirëpo llamba UV konsiderohet si një nga materialet kyçe për verifikimin e votuesve. Rastet e verifikuara sidomos në raundin e parë të zgjedhjeve ishin në Prizren (7 raste), Prishtinë (3 raste), Ferizaj (3 raste) dhe Gjakovë (2 raste). Në raundin e dytë, rastet më të shpeshta ishin në Gjakovë (4 raste) dhe Pejë (2 raste). Në vendvotimin 2504D/04R në Shkollën Bujqësore “Zenel Hajdini” në Ferizaj,


llamba UV nuk funksionoi, pastaj u ndryshua, dhe më vonë prapë nuk funksionoi dhe për 20 minuta vendvotimi përdori një llambë nga një tjetër VV.

Përafërsisht numër i njëjtë i rasteve u vërejt kur vula mungonte apo nuk funksiononte, e cila shërben si mjet për të shmangur falsifikimin e fletëvotimit, dhe kur nuk funksiononte ngjyra spërkatëse që përdoret për të verifikuar votuesin. Vendvotimet me probleme të tilla ishin në “Topnicë, Kamenicë 1002/01R në shkollën fillore “Rexhep Malaj” ku lista e kandidatëve u humb”. Shkolla fillore “Dardania” VV 1904E08R në Prishtinë, faqja 34 e librit të votuesve mungonte. Gjakovë, Gjimnazi Hajdar Dushi” VV 0201C/03R – 899 votues në listën e votuesve, kurse kishte vetëm 550 fletëvotime. Ferizaj 2501D06R, shkolla fillore “Tefik Çanga”, ngjyra e vulës u soll pas një ore (balotazh).

### (Mos)qasja për personat me aftësi të kufizuar

Mosqasja e qendrave të votimit për personat me aftësi të kufizuar ka qenë një çështje problematike për zgjedhje pasi që kjo ua vështirëson atyre arritjen në qendrën e tyre të votimit. Ishte e zakonshme për vëzhguesit që të shohin persona, sikurse komisionerët dhe menaxherët e qendrave të votimit, duke bartur njerëz në karrige me rrota nga oborri i qendrës së votimit tek vendvotimi pasi që nuk ka pasur platforma të pjerrëta apo mbajtëse për këta. Më shumë se një nga tri qendra votimi u regjistruan si plotësisht e paarritshme për personat me aftësi të kufizuar. Në komunat ku kishte balotazh, proporcioni i mos-qasjes ishte edhe më i lartë. Kjo situatë duket se është përmirësuar pak nga viti 2007 ku më shumë se gjysma e qendrave të votimit nuk kishin infrastrukturën e duhur për qasje për invalidë në klasa/vendvotime.

### Qasja e Personave Me Aftësi të Kufizuar



Kjo vjen kryesisht për shkak se Ministria e Arsimit por edhe qeveritë lokale kanë investuar që të bëjnë platformat e pjerrëta të nevojshme në shkolla që shpesh përdoren si qendra votimi në Ditën e Zgjedhjeve. Është e qartë që KQZ dhe KKZ-të varen nga infrastruktura e shkollave publike për të organizuar procesin e votimit. Shkollat fillore, ku qeveria lokale ka shumicën e kompetencave, janë sidomos thelbësore pasi që ato janë në numër më të madh dhe më të shpërndara në zonat rurale.


## Parregullsitë e zakonshme gjatë votimit

Sfidat kryesore të këtyre zgjedhjeve ishin disa nga të njëjtat çështje që përsëriten nga zgjedhjet e kaluara. Lista e votuesve, votimi familjar, përpjekjet për të votuar dy herë pa ndonjë pasojë kanë prishur qetësinë relative të procesit të votimit në vitin 2013. Rregullorja e re për parandalimin e fotografimit të votës gjithashtu shkaktoi disa probleme në ca vendvotime.

### Lista e votuesve

Një element themelor për një proces të duhur zgjedhor është Lista e votuesve, që saktësisht përmban të gjithë votuesit me të drejtë vote dhe cakton qendrën e votimit më të afërt nga vendbanimi i tyre. Dy problemet kryesore me të cilat Lista e votuesve përballat aktualisht janë: mospërputhja e vendbanimit të votuesve me qendrën e votimit të tyre dhe prezenca e emrave të personave të vdekur në Listën e votuesve.

Pasi që KQZ përpilon Listën e votuesve duke u bazuar në të dhënat e regjistrit civil të mirëmbajtur nga Ministria e Punëve të Brendshme, një pjesë e madhe e përgjegjësisë për saktësinë e të dhënave bie mbi këtë të fundit. Në masë të madhe Lista e votuesve është aq e mirë sa është edhe regjistri civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Megjithatë, me ligj, KQZ ka për detyrë që të mirëmbajë dhe administrojë Listën e votuesve. Prandaj, kjo duhet të krijojë mekanizmin e vet për korrigjimin e të dhënave që i pranon nga MPB, nëse kjo e fundit nuk është në gjendje ta bëjë vet.



Caktimi gabimisht i qendrës së votimit për shkak të pasaktësive në adresa dhe në disa raste mungesës totale të një adrese për një votues me të drejtë vote, bashkë me një fushatë vetëdijesimi të dobët, ka qenë shkak për konfuzion gjatë Ditës së Zgjedhjeve. Kjo është arsyeja që më shumë se 17,000 votues, apo përafërsisht 2% e të gjithë personave që morën pjesë në zgjedhje, kishin problem që të gjenin emrin e tyre në Listën e votimit kur u paraqitën aty ku ata kishin menduar së është vendvotimi i tyre. Ky është numri që vëzhguesit e DnV-

së ishin në gjendje që të vëzhgonin dhe të raportnin, edhe pse ky është një problem edhe më i përhapur.


Prizreni kishte numrin më të lartë të personave që nuk mund ta gjenin emrin e tyre në listën e vendvotimit ku ata shkuan të votonin, por Mitrovica dhe Klina kishin proporcionin më të lartë të votuesve që nuk mund të gjenin emrat e tyre në listë. Në shkollën “11 Marsi” në Prizren, në katër vendvotimet e saj (08, 10, 12 dhe 14) kishte 22 votues që nuk mund të gjenin emrin e tyre në listë dhe 3 nga ta ishin votues për herë të parë. Në shkollën fillore “Liria” në Pograxhë, Gjilan (VV 02), një nga votuesit me nervozë deklaroi që ai nuk do të votojë fare pasi që ishte i frustruar se nuk mund të gjente emrin e tij në listë. Probleme të tilla ku votuesit u kthyen prapa për shkak se nuk mund të gjenin emrin e tyre në listë u regjistruan në Mitrovicë (Kushtova VV 01 dhe 02, Fillorja “Ismail Qemajli” VV 02, Fillorja “Minatorët” VV 02). Në shkollën fillore “Naim Frashëri” në Vushtrri, në të 5 VV-të kishte votues që u kthyen prapa për shkak të listës së votuesve.

Por problemi për të cilin KQZ është plotësisht përgjegjëse është numri i lartë i të vdekurve në listë. Jo vetëm ata që kanë vdekur rishtazi. Në shkollën fillore “Zekrija Rexha” në Gjakovë votuesit e VV 01 dhe 03 identifikuan 34 anëtarë të familjes që kishin vdekur 10-12 vite më parë. Në një rast, votuesi i bëri vijë emrit të anëtarit të vdekur të familjes në listë, që është shkelje e procedurave të votimit. Në shkollën fillore “Musa Zajmi” në Gjilan, një votues protestoi se ai nuk do të votojë derisa emrat e personave të vdekur që ai njihnte largohen nga lista. Në shkollën fillore “Bedri Gjina” në Sitnicë, VV 04, 3 persona u identifikuan si të vdekur në balotazh dhe një burrë u ankua se pse edhe në balotazh, gruaja e tij, që kishte vdekur para 8 viteve, nuk ishte larguar nga lista e votuesve.

Qasja për përmirësimin e Listës së votuesve duhet të ndryshojë pasi që përpjekjet aktuale nuk janë duke prodhuar efekt. KQZ ka nevojë që të rishikojë p-kodet dhe ud-kodet për caktimin e qendrës së votimit për votues dhe duhet të ofrojë një mekanizëm që në Ditën e Zgjedhjeve, votuesit që dalin të votojnë në qendrën e votimit të gabuar, kanë mundësi që të korrigojnë informacionin e tyre mbi adresat aty për aty.

### **Votimi familjar**

Fshehtësia e votës është një e drejtë e garantuar me Kushtetutë. Kjo është e drejta për të votuar në fshehtësi të plotë në një kabinë të ndarë edhe nga anëtarët më të ngushtë të familjes. Një veprim që shkel të drejtën e votimit të fshehtë dhe shfaqet në të gjitha zgjedhjet e organizuara deri tani është i ashtuquajtur “votim familjar”. Demokracia në Veprim e sheh si praktikë të mirë dhe normale që familjet shkojnë në qendra votimi së bashku, megjithatë, vazhdimisht ka bërë thirrje kundër asaj që anëtarët e familjes të jenë prezent në kabinën e votimit në të njëjtën kohë.



## Vendvotime me Votim Familjar

Edhe Rregulla Zgjedhore e KQZ-së 09/2013 e miratuar më 2 korrik 2013 thekson në Nenin 15.4 se vetëm një person duhet të lejohet prapa kabinës, në çdo kohë, përveç rasteve kur votuesi ka nevoja të veçanta dhe kërkon ndihmë.

Votimi familjar ndodh kur disa persona, me justifikimin e afërsisë familjare, votojnë në të njëjtën kabinë votimi. Si dukuri, është raportuar në 33.1% të vendvotimeve në raundin e parë të zgjedhjeve lokale 2013 dhe 21.1% të vendvotimeve gjatë balotazhit. Kjo është më e ulët se raportimi i Demokracisë në Veprim për zgjedhjet e përgjithshme 2010, por është ende shumë e lartë. Votimi familjar ndodhi në shumicën e rasteve kur një burrë apo djalë votonte në kabinë kur gruaja apo nëna ishte duke votuar. Shumë komisionerë, si pjesëtarë të shoqërisë, e shohin këtë si një bashkëshort që ndihmon bashkëshortin tjetër, por kjo në fakt cenon fshehtësinë e votimit. Votimi familjar dallon nga “votimi i ndihmuar” kur një personi i lejohet, ligjërisht, të ndihmojë një votues që nuk di të lexojë apo të shoh mirë. Votimi familjar nuk është i rregulluar nga KQZ dhe mund të jetë i vështirë për tu rregulluar, edhe pse nuk është e pamundur, por komisionerët duhet të trajtohen më mirë për të parandaluar rastet e tilla, që janë ende mjaftë të përhapura.

Disa raste të regjistruara të votimit familjar në raundin e parë të zgjedhjeve kanë qenë: në shkollën fillore “Ismail Luma” në Lipjan me 15 raste të regjistruara; në shkollën fillore “Zenel Hajdini” me 15 raste; Llugaxhi me 7 raste; Rubovc 5 raste, në Godanc të Poshtëm, Shtime, vëzhguesi numëroi 38 raste të votimit familjar; në Prekaz të Epërm, Skenderaj 10 raste të votimit familjar; në Doberdelan, Suharekë u shënuan 23 raste të votimit familjar; në “Meto Bajraktari” Softaj, Ferizaj 3 raste; “Vuk Karagjic”, Greme, VV 05R kishte 14 raste të votimit familjar; në “Besim Brecaj” Prizren VV 01R kishte 6 raste të votimit familjar; në qendrën e votimit “Mustafa Bakija” 5 raste; në shkollën

fillore “Bajram Curri” në Rahovec u shënuan 3 raste të votimit familjar; në shkollën “Thimi Mitko” në Gjilan u shënuan 7 raste.

Në shkollën fillore “Jeronim DeRada” në Ferizaj, komisionerët u desh që të largonin një person nga qendra e votimit për shkak se ai insistonte që të votonte për gruan e tij që ishte e pranishme aty.

### **Përpyekjet për votim të dyfishtë**

Përpyekjet për votim mashtrues, në formën e përpyekjes për të votuar dy herë apo “votimi i dyfishtë”, është një tjetër shqetësim për të cilin vëzhguesit e Demokracisë në Veprim ishin trajnuar që ta verifikonin. Komisionerët janë të trajnuar që të parandalojnë këtë lloj veprimi, dhe procedura e votimit ka kontrolle për t'i parandaluar këto, por ndonjëherë kjo mund të mos vërehet. Kishte disa përpyekje në këtë cikël zgjedhor dhe këto kishin prirje që të prishnin qetësinë e procesit të votimit në disa vendvotime.

Vëzhguesit e DnV-së shënuan 74 raste të votimit të dyfishtë në të gjitha 2.366 vendvotimet në Kosovë. Nga 18 komunat ku ky veprim u shënuar, Prishtina kishte numrin më të madh të vendvotimeve ku kishte së paku një përpyekje të votimit të dyfishtë me 13 tentime, në Pejë kishte 11 raste, në Skenderaj 8 raste, në Gjakovë 8 raste, dhe në Prizren 7 raste të shënuara. Në shtatë komuna kishte nga një rast të izoluar. Kurse gjatë balotazhit, rastet e identifikuara zbritën në 30, dhe vetëm Gjakova kishte një rast më tepër të përpyekjes për votim të dyfishtë në krahasim me raundin e parë, që buron ndoshta nga intensifikimi i fushatës në balotazh.

Disa nga rastet që shkaktuan pengesa më të mëdha në procesin e votimit ishin në shkollën fillore “Lidhja e Prizrenit” në Pejë, ku i njëjti person tentoi të votojë shumë herë por u kthye prapa. Në shkollën fillore “Yll Morina” në Gjakovë VV 02, ku i njëjti person insistonte të votonte edhe pse ishte verifikuar se ai kishte votuar më parë. Në balotazh, në shkollën “Selman Riza” Piskotë (Gjakovë) kishte katër përpyekje të votimit të dyfishtë dhe në “Mustafa Bakija” (Gjakovë) kishte një përpyekje të raportuar për votim të dyfishtë. Në shkollën fillore “Mati Logoreci” në Prizren, VV 04 kishte një përpyekje për votim të dyfishtë dhe në shkollën “11 Marsi” VV 01, dy persona të etnisë turke insistonin që të votonin edhe pse llambat UV tregonin ngjyrë në gishtat e tyre. Në disa raste, përpyekjet ishin të suksesshme, sikurse në “Tefik Çanga” VV 02 në Ferizaj, një person hyri nga një klasë tjetër dhe ju lejua të votojë edhe pse gishti i tij ishte spërkatur më parë. Gjithashtu në shkollën fillore “Ahmet Hoxha” në Ferizaj, kishte një person që vëzhguesi e kishte parë që kishte votuar për herë të dytë.

### **Fotografimi i votës së shënuar**

KQZ, me iniciativën e anëtarit të LDK-së në këtë institucion, morri një vendim në tetor 2013 që të ndalojë fotografimin e fletëvotimit gjatë kohës së votimit. Ky vendim është marrë me të drejtë, me qëllim të parandalimit të blerjes së votës. Megjithatë, interpretimi i PZAP-it se ka disa përjashtime nga vendimi shkaktoi


konfuzion edhe në mesin e komisionerëve. Prandaj, kjo çështje duhet të rregullohet nga Kuvendi i Kosovës dhe të pasohet me udhëzime të qarta për zbatim.

Përprjekjet e KVV-ve për të zbatuar këtë vendim të KQZ-së, shkaktuan, në disa momente, tensione në procesin e votimit dhe prishën qetësinë e procesit. Vëzhguesit e DnV-së shënuan 38 raste të fotografimit të votës dhe 18 raste tjera gjatë balotazhit. Në disa raste, siç u cek më lartë, kjo shkaktoi konfuzion. Në shkollën “Asim Vokshi” në Prishtinë, pasi që një votuese u pa që fotografoi votën me telefonin e saj mobil, komisionerët e urdhëruan atë që ta fshijë, por ajo insistonte se nuk dinte si ta bënte këtë. Në shkollën “Luciano Mitroni” VV 02 në Prizren një votues fotografoi listën e votimit, e cila mund të tregonte se kush kishte votuar dhe kush nuk kishte votuar ende.

### Incidentet gjatë procesit të votimit

Gjersa procesi i votimit gjatë zgjedhjeve lokale 2013 ishte në përgjithësi relativisht i qetë, kishte disa incidente të izoluar që kanë trazuar procesin e votimit. Disa incidente ishin në formën e kërcënimeve kurse tjerat ishin incidente pasi që vendvotimet u mbyllën për kohë të shkurtër. Në përgjithësi, u shënuan 19 incidente në 2.366 vendvotime në raundin e parë dhe 9 incidente në zgjedhjet për balotazh.

### Ç'rregullime të Procesit



Në mesin e incidenteve të shënuara nga vëzhguesit tanë ishin rasti në Mitrovicë. Në qendrën e votimit 1116b/01 tek “Tuneli i parë”, dy koordinatorë (ofrues të ushqimit) të PDK-së dhe AKR-së, filluan një përleshje fizike brenda vendvotimit. Policia i arrestoi personat në fjalë dhe ftoi prokurorin të procedojë rastin. Në shkollën fillore “Yll Morina” VV 07 në Gjakovë, menaxheri i qendrës së votimit votoi pa dokument identifikimi. Një vëzhgues nga një subjekt politik kundërshtoi rastin, dhe procesi i votimit u ndërpre për rreth 20 minuta. Pas intervenimit të policisë dhe prokurorit, vendvotimi u hap dhe procesi i votimit



vazhdoi. Në Varosh të Ferizajt u dyshua se një automjet civil posedonte një kuti votimi. Një dëshmitar pyeti shoferin se pse kishte një kuti votimi brenda automjetit, dhe përgjigja ishte se kutia ishte dëmtuar dhe duhej të zëvendësohej. Vëzhguesit e DnV-së pyetën Komisionin Komunal Zgjedhor nëse ka pasur një problem të tillë me kutitë e votimit, por sipas KKZ-së nuk kishte ndonjë problem të tillë. Në “Shkollën Teknike” në Mitrovicën e Veriut, kishte tentime për të votuar me dokumente të identifikimit false dhe tentime për të votuar më shumë se një herë, që trazuan procesin e votimit.

Prishtina kishte mjaftë vendvotime me incidente. Në shkollën fillore “Asim Vokshi” VVo2, llamba nuk punoi dhe si rezultat, procesi i votimit u ndërpre për disa minuta, kurse më vonë procesi vazhdoi. Në shkollën fillore “Hasan Prishtina” VVo8, një person gjeti nënshkrimin e një personi tjetër në listën e votimit. Në shkollën fillore “Naim Frashëri” vendvotimi u mbyll për 15 minuta pas orës 16:00. Në shkollën fillore “Shkëndia” erdhi policia pasi që u raportua se një person përpiquej të manipulonte procesin e votimit.

Në Babaj i Bokës në Gjakovë, VV 01, u raportua që një person kishte tentuar që të votonte me dokumentin identifikues të vajzës së tij. Në shkollën fillore “Yll Morina” kishte shqetësime kur komisionerët e AAK-së kishin sjellë një paketë të votave pa qenë nevoja. Në shkollën fillore “Lidhja e Pejës” në Novosellë të Pejës, njerëzit vazhdimisht hynin në qendrën e votimit për të lobuar për vota. Në shkollën fillore “Kongresi i Manastirit” në Sibovc të Epërm të Podujevës, një vëzhgues partiak u arrestua për shkak të dokumentit identifikues të falsifikuar. Në shkollën fillore “Qemajl Bakija” në Dol të Gjakovës u raportuan kërcënime, kur një militant i AAK-së provokoi verbalisht komisionerët. Gjatë balotazhit në Ferizaj, kishte një konflikt verbal në mes dy komisionerëve që eskaloi nga një diskutim lidhur me procedurën për votimin e asistuar. Në shkollën fillore “Migjeni” në Ruvc të Ri të Lipjanit kishte ndërprerje të rrymës që filloi në ora 15:35.

Të gjitha rastet më lartë trazuan procesin e qetë zgjedhor në një mënyrë apo tjetrën dhe shkaktuan intervenimin e autoriteteve policore. Raste të tilla mund të kontrolloheshin më mirë nga komisionerët nëse ata do të trajtoheshin më mirë, kurse disa raste tjera u shkaktuan për shkak se keqbërësit u rreshtuan krahas subjekteve politike.

## Procesi i votimit në Veri

OSBE-ja ishte më e përfshirë në administrimin e zgjedhjeve në veri dhe pasiguria gjatë procesit të votimit kishte krijuar një atmosferë tjetër votimi nga pjesa tjetër e Kosovës. Për shkak të faktit se votimi në katër komunat më veriore të Kosovës (duke përfshirë komunën e re të Mitrovicës Veriore) u organizuan me plan tjetër logjistik, ky raport do të ofrojë një pasqyrë të veçantë të procesit të votimit në këtë pjesë të Kosovës.

### Procesi i votimit para mesditës

Votimi filloi qetë dhe pa incidente në Leposaviq dhe Zubin Potok. Raportet nga vëzhguesit në terren vërejtën vonesa prej 10-15 minutash në hapjen e qendrave të votimit, sidomos në Mitrovicën e Veriut. Fillimisht, pjesëmarrja ishte e ulët çdo kund dhe vazhdoi të jetë jashtëzakonisht e ulët në Mitrovicë të Veriut dhe Zveçan, me qendrën kryesore (Sveti Sava) që raportoi vetëm 75 votues deri në mesditë. Në Zubin Potok dhe Leposaviq, pjesëmarrja ishte në mënyrë të konsiderueshme më e lartë, duke arritur 20% në disa qendra votimi.

Që nga ora 06:30 në mëngjes, vëzhguesit u vendosën në shumicën e qendrave të votimit në Mitrovicën Veriore duke përfshirë “Shkollën Teknike”, Shkollën e mesme të mjekësisë dhe Shkollën ‘Sveti Sava’ që shërbeu si qendra kryesore e votimit për atë zonë. Kishte raporte nga vëzhguesit e vendosur në shkollën ‘Sveti Sava’ që grupe të personave të veshur me të zeza, të ngjashme me uniforma ushtarake qëndronin në grupe para qendrës së votimit por nuk i kërcënonin aktivisht votuesit, vëzhguesit dhe punonjësit tjerë në qendrën e votimit. Raporte të ngjashme u dëgjuan nga vëzhguesit tjerë në Mitrovicën e Veriut, megjithatë, deri në orën 13:00 të 3 nëntorit, shumica e qendrave të votimit ishin relativisht të qeta.

### Tensionet e votimit pasdite

Mbikëqyrësit e vëzhguesve ishin në kontakt me përfaqësuesit ndërkombëtarë gjatë gjithë ditës dhe konsensusi i përgjithshëm ishte që gjendja e sigurisë nuk ishte e rrezikshme menjëherë, pasi që nuk kishte raporte të dhunës fizike apo kërcënime për dhunë fizike. Me të thënë këtë, vëzhguesit vërejtën njerëz që ju afruan vendvotimeve dhe pastaj tërhiqeshin kur panë turmat që duke brohoritu iu drejtuan votuesve. Për më tepër, votuesit dhe punonjësit e vendvotimeve u filmuan nga turmat, me një laptop që u vendos afër hyrjes së ‘Sveti Savës’ që filmonte njerëzit që hynin në qendër të votimit dhe ndoshta ofronin pamje të drejtpërdrejta në internet.

Rreth orës 15:00 pasdite, vëzhguesit në Shkollën Teknike vërejtën që turma para qendrës së votimit ishte duke u rritur dhe kishte arritur në rreth 50 persona në orën 16:00. Për më tepër, kishte raporte që ata në mënyrë aktive (fizikisht) parandalonin njerëzit që të hynin në qendër të votimit.

Rreth orës 17:00 vëzhguesit vërejtën se turma kishte filluar të sulmojë qendrën votuese ‘Sveti Sava’ dhe gjuante gaz lotsjellës në ndërtesë dhe ngacmonte punonjësit dhe vëzhguesit e qendrës së votimit. Një vëzhgues ishte dëshmitar kur një grua u lëndua duke kërcyer nga dritarja. Rreth së njëjtës kohë, një vëzhgues i vendosur në Shkollën e Mesme të Mjekësisë gjithashtu raportoi që qendra ishte duke u sulmuar dhe zyrtarët ishin duke ikur nga vendngjarja. Duhet cekur se në asnjë moment Policia e Kosovës apo OSBE-ja nuk ofroi ndihmë për vëzhguesit civil. Vëzhguesit në Shkollën Teknike ikën nga qendra e votimit por u ndoqën në rrugë nga huliganë që i panë ata se po largohen nga shkolla. Në përgjithësi, situata në Mitrovicën e Veriut ishte kaotike dhe konfuze,

me turma të njerëzve të veshur të të zeza që patrullonin zonat afër qendrave të votimit.

### **Ndërprerja e procesit në Mitrovicën e Veriut**

Siguria e personave të përfshirë në procesin zgjedhor ishte shqetësimi thelbësor në prag të zgjedhjeve dhe u bë problem i madh kur ishte në fjalë rekrutimi i vëzhguesve. Kjo ishte sidomos problematike në komunën e Zveçanit (që konsiderohet veçanërisht si pjesë e vijës së ashpër).

Si rezultat i situatës në Mitrovicën e Veriut, vëzhguesit në Zubin Potok informuan DnV-në që rreth orës 18:00 votimi ishte ndërprerë në ato komuna dhe OSBE-ja ishte larguar nga qendrat e votimit. Si rezultat i kësaj, kishte konfuzion të përgjithshëm se kur dhe ku do të ndodhë numërimi i votave dhe kush i kishte marrë apo kush i ruante kutitë e votimit.

### **Rivotimi në Mitrovicën e Veriut**

Për shkak të dhunës gjatë votimit të parë në Mitrovicën e Veriut, Demokracia në Veprim kishte probleme në rekrutimin e vëzhguesve për procesin e rivotimit për shkak të shqetësimeve lidhur me sigurinë personale. Pavarësisht kësaj, Demokracia në Veprim arriti që të rekrutonte rreth 23 vëzhgues. Megjithatë vetëm 10 prej tyre u akredituan nga KQZ pasi që shumica nga ta nuk kishin dokumentet e Republikës së Kosovës të nevojshme për akreditim të vëzhguesve lokal.

Autoritetet kosovare ishin shumë më të përgatitura për ri-votimin në Mitrovicën e Veriut, Prokuroria e Kosovës kishte dy prokurorë që punonin me EULEX-in në terren në tri qendrat e votimit në Mitrovicën e Veriut. U raportua se Policia e Kosovës kishte 200 policë në terren për të siguruar proces të sigurt zgjedhor<sup>14</sup>.

Procesi i ri-votimit në Mitrovicën e Veriut, edhe para hapjes së votimit u karakterizua me një incident, kur rreth orës 6:30 të mëngjesit, një grup i njerëzve që e quanin veten "Mbrotjtja Civile" ndërprejnë komisionerët që të vazhdojnë me hapjen e vendvotimeve. Megjithatë, menjëherë pas kësaj, ata u larguan nga autoritetet e EULEX-it dhe masa shtesë u morën për të siguruar qendrën e votimit. Gjatë pjesës tjetër të ditës, atmosfera ishte e qetë me siguri të lartë rreth vendvotimeve. Shqetësimi kryesor ishin grupe të njerëzve që vinin të votonin në mënyrë të organizuar, që ishte indikacion se kishte presion votimi jashtë qendrave të votimit. Megjithatë, procesi i votimit mbeti i qetë deri sa votimi u mbyll. Numërimi i votave u bë në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve në Fushë Kosovë.

---

<sup>14</sup> Telegrafi.com. Pula: Policia largoi "Civilna Zastita" nga qendrat e votimit në veri. 17 nëntor 2013.

## Rivotimi in Zveçan

Duke u bazuar në parregullsitë e hasura në tri vendvotime në Zveçan, PZAP mori vendim që të dërgohet Zveçani në rivotim. KQZ vendosi të organizojë rivotimin vetëm në këto tri vendvotime edhe pse këto ishin në qendra më të mëdha votimi. Kjo e bëri sfiduese për KQZ-në që të ftojë votuesit vetëm për këto vendvotime pasi që shumica e votuesve e dinë vetëm qendrën e votimit të tyre dhe jo vendvotimin e caktuar. Pasi që kishte vetëm dy kandidatë që garonin në zgjedhjet për kryetar komune të Zveçanit, KQZ vendosi që të organizojë rivotimin në ditën e njëjtë me zgjedhjet e balotazhit në komunat tjera. Procesi në rivotim rrjedhi i qetë dhe pa incidente të theksuara.

## Rivotimi në Partesh

Një qendër votimi me të tri vendvotimet e saj u anulua nga PZAP-i në Partesh, një komunë me gjithsej tri qendra votimi. Rivotimi në këtë rast u urdhërua për shkak të parregullsive në zgjedhjet e balotazhit për kryetar komune. Rivotimi u urdhërua për 15 dhjetor 2013, një ditë jashtëzakonisht e ftohtë në klasa me shumë pak ngrohje. Kjo situatë reflektoi keq tek votuesit, që kishin dalë për të tretën herë të votojnë për të njëjtat zgjedhje. Rivotimi në Partesh u përcoll me situata të tensionuara kohë pas kohe kur grupe përkrahëse të të dy kandidatëve grumbulloheshin para qendrës së votimit. Prania e shtuar e forcave të sigurisë bëri që situatë mos të eskaloj dhe procesi i rivotimit të kalojë pa problem të mëdha. Një parregullësi që kanë vërejtur vëzhguesit e DnV-së në këtë proces ka qenë votimi me asistencë. Përderisa të gjitha rastet e votimit me asistencë janë shënuar në librin përkatës, e që ka qenë numër shumë i madh, në shumicën absolute të rasteve në kabinën e votimit ka shkuar vetëm asistuesi, përderisa personi për të cilin votohej qëndronte në hyrje të vendvotimit.


## Procesi i numërimit

Është e qartë që procesi i numërimit duhet të plotësojë pesë kritere, do të thotë, saktësinë e numërimit, transparencën gjatë numërimit, efikasitetin, mundësinë për rinumërim dhe përsëritje, dhe mbrojtjen e fshehtësisë së votës. Misioni ynë vëzhgues në të gjitha qendrat e votimit në Kosovë është dëshmitar i faktit që procesi i numërimit ishte transparent, kishte hapësira për rinumërim dhe përsëritje dhe fshehtësia e votës ishte e mbrojtur gjatë procesit të numërimit. Numërimi ishte i saktë për shumicën e vendvotimeve, megjithatë përcaktimi nëse një votë ishte e vlefshme apo e pavlefshme ishte i diskutueshëm në disa momente. Nëse e shikojmë saktësinë në kuptim të precizitetit të numërimit të votave të pavlefshme, komisionerët e vendvotimeve në këtë rast mund të kishin performuar më mirë. Natyrisht, në disa momente vendimi për të deklaruar një votë si të pavlefshme është subjektiv por për shkak se të gjithë komisionerët duhet të pajtohen, është shumë e vështirë të njihet një votë si e vlefshme përveç nëse votuesi ishte absolutisht i saktë.

## Periudha e numërimit të votave

Efikasiteti i votimit mund të përcaktohet nga periudha që ju desh një vendvotimi që të numërojë fletëvotimet e tij dhe të mbushë si duhet procesverbalin e numërimit. Numërimi filloi menjëherë pas orës 19:00 në tre të katërtat e vendvotimeve, në raundin e parë, dhe gati të gjitha në raundin e dytë. Periudha që u desh që të përfundohej numërimi, megjithatë, nuk ishte shumë efikase.

Raundi i parë i votimit, më 3 nëntor, ishte pak më shumë i ngarkuar pasi që kishte vota për kuvende komunale dhe për kryetar komunash. Për shkak të faktit që votat për zgjedhjet komunale ishin pak më të komplikuar, pasi që votuesi duhej të shënonte subjektin politik dhe një kandidat, kjo rriti mundësinë që të shënohej gabimisht fletëvotimi dhe kështu, do të merrte më shumë kohë gjatë numërimit.



Megjithatë, fakti që gati gjysma e vendvotimeve përfunduan numërimin në ora 23:00 apo pak më vonë, tregon që periudha prej pesë orësh për numërimin e më pak se 1000 votave ishte paksa e zgjatur.

Legjislacioni në fuqi gjithashtu lejon që çdo anëtar i KVV-së të kundërshtojë rezultatet gjatë numërimit dhe opinioni kundërshtues duhet të shënohet në Librin e Votimit. Vëzhguesit e zgjedhjeve shënuan tetë raste të tilla në raundin e parë të zgjedhjeve dhe pesë gjatë balotazhit. Në shkollën fillore “Gazmend Zuka” në Deçan, komisioneri i LDK-së refuzoi të njohë rezultatet në mënyrën që ishin numëruar ato. Në “Fakultetin Teknik” në Prishtinë, komisioneri i PDK-

Nr. i Vendvotimeve Ku Është Refuzuar Rezultati										
	Pri	Suh	Priz	Malshv	Gjil	Fer	Deç	Gjak	Pej	Drag
Raundi 1-rë	2	1	1	1	1	1	1			
Balotazh			1					2	1	1

së refuzoi rezultatet siç ishin numëruar. Në shkollën fillore “Shaban Hashani” në Ferizaj, menaxheri i qendrës së votimit që nuk ishte prezent në vendvotim gjatë numërimit refuzoi rezultatet, edhe pse ligji nuk e lejon menaxherët e qendrave të votimit të refuzojnë numërimin.


Pas numërimit, komisionerët duhet ti lënë mënjanë votat e pavlefshme, t'i vendosë të gjitha votat e tilla në qese plastike transparente, dhe ti lënë mënjanë votat me kusht, në ato vendvotime që ka pasur vota të tilla. Procedura e njëjtë duhet të ndiqet për votat për kryetar komune sikurse edhe për votat për kuvende komunale. Gjersa në shumicën e vendvotimeve këto procedura u respektuan, në shtatë vendvotime votat e pavlefshme nuk u lanë mënjanë dhe në 3.7% të vendvotimeve votat me kusht nuk u numëruan veçmas dhe votat e pavlefshme nuk u shënuan qartë.

Në përgjithësi, procesi i numërimit ishte i qetë si në raundin e parë dhe në balotazh, duke anashkaluar faktin që qendrat e votimit në veri u penguan nga dhuna dhe rivotimi në Mitrovicë të Veriut ku numërimi ishte bërë në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve në Fushë Kosovë në vend se në vendvotime.

## VI. Pjesëmarrja e votuesve

Pjesëmarrja e votuesve në zgjedhjet lokale 2013 ishte mjaft e lartë dhe pjesëmarrja e votuesve serbë në Kosovë ndihmoi në rritjen e përgjithshme të pjesëmarrjes. Zgjedhjet lokale të fundit në Kosovë panë numrin më të lartë të votuesve që kishin dalë ndonjëherë. Në përgjithësi, më shumë se 811 mijë votues dolën në votime. Numrat zyrtarë tregojnë që 46.3% e personave me të drejtë vote morën pjesë, por duke konsideruar listën e fryrë të votuesve me emra të personave që nuk jetojnë më në Kosovë dhe emra të njerëzve që kanë vdekur, kjo përqindje është shumë më e lartë. Pjesëmarrja e votuesve në zgjedhjet lokale sjell një trend në rritje nga zgjedhjet e fundit, por sidomos me zgjedhjet e vitit 2007 kur pjesëmarrja e votuesve në Kosovë përjetoi uljen më të madhe.

### Dalja në Zgjedhjet e Kaluara




Komunat me shumicë serbe ishin në mesin e atyre me pjesëmarrjen më të lartë të votuesve dhe atë më të ulët. Pjesëmarrja me e lartë u shënuar në komunat e Parteshit (63.8%), Kllokotit (61.2%), Shtërpçës (58.6%), Ranillugut (58.4%) dhe Graçanicës (54.6%). Kurse komunat me pjesëmarrjen më të ulët të votuesve, sipas të dhënave zyrtare, ishin Mitrovica e Veriut (22.2%), Leposaviqi (23.5%) dhe Zubin Potoku (31.1%).

Mamusha, edhe pse me vetëm katër vendvotime, ishte komuna me përqindjen më të lartë të pjesëmarrjes prej 64.6%. Në mesin e komunave më të mëdha me pjesëmarrje të lartë të votuesve ishin Lipjan (54.9%), Malisheva (52.7%), Gjilani (52.6%), dhe Kamenica (51.3%). Kryeqyteti i Prishtinës kishte pjesëmarrje të respektueshme të votuesve me 50.8%, por që ishte më e ulët se pjesëmarrja në zgjedhjet nacionale të vitit 2010.


Pjesëmarrja e votuesve në zgjedhjet e balotazhit ishte 40.2% në komunat ku kandidatët për kryetarë komune nuk fituan 50%+1 të votave. Është e natyrshme për votuesit që të dalin në numra më të ulët në balotazh, mirëpo ky nuk ishte rasti në të gjitha komunat. Në balotazh, vetëm Gjakova kishte pjesëmarrje më të lartë (54.02%) se në raundin e parë të zgjedhjeve (43.2%).

Gjersa pjesëmarrja në fund të procesit ishte e respektuar, orët e para të Ditës së Zgjedhjeve u karakterizuan me pjesëmarrje jashtëzakonisht të ulët. Vetëm 12% e votuesve dolën për të votuar para mesditës, dhe vetëm 7.7% gjatë balotazhit. Periudha më dinamike e votimit ishte në mes orës 12:00 dhe 15:00. Gjysma e votuesve dolën të votojnë gjatë këtyre tri orëve të ditës, kurse votimi ishte i hapur për së paku 12 orë të ditës. Kjo, padyshim, lidhet me ditët e ftohta të dimrit kur u mbajtën zgjedhjet lokale 2013, por kjo vetëm është bërë traditë për zgjedhjet e Kosovës.



## Votat e pavlefshme

Votuesit dalin që të votojnë me pritjen që përzgjedhja e tyre e liderëve të zgjedhur do të shkojë drejt numërimit përfundimtar. Megjithatë, nëse një votë shpallet e pavlefshme, kjo do të thotë që përzgjedhja e votuesit për liderët e zgjedhur nuk do të numërohet. Kjo është arsyeja që një nga problemet kryesore lidhur me këtë proces zgjedhor janë votat e pavlefshme për kandidatët e kuvendeve komunale.



Një në dhjetë vota për zgjedhjet për kuvende komunale nuk u numërua për shkak se u shpall e pavlefshme, ose për shkak se votuesi shënoi kutitë për kandidatë por jo ato për parti politike, ose për shkak se shenja e tyre u vlerësua e paqartë për njërin kandidat apo tjetrin, ose votuesit shënuan më shumë kuti në kolonën e partive se që është dashur të shënonin, apo se vota ishte dëmtuar në proces apo kishte mbetur e paplotësuar.

Kjo mund të ketë ndoshtur për shkak të mungesës së informacionit të nevojshëm se si të plotësohet fletëvotimi. Votuesit për herë të parë apo votuesit e moshuar janë ndoshta votuesit me më pak njohuri për shënimin e fletëvotimit dhe mund të jenë shkak i përqindjes së lartë të votave të pavlefshme.

Kishte 70,729 vota të pavlefshme për kuvende komunale, 12,775 u konstatuan nga komisionerët si vota të zbrazëta, dhe 1,466 u konsideruan si vota të dëmtuara. Këto shifra janë më të larta se votat e pavlefshme në vitin 2009 për të njëjtin lloj të zgjedhjeve. Sa i përket pjesëmarrjes në votat e hedhura, këta numra të mbledhur tejkalojnë 10% të votave të hedhura. Komunat me numrin më të lartë të votave të pavlefshme ishin Drenasi, Vushtrria, Ferizaj, Mitrovica, Vitia dhe Kaçaniku.

Votat e pavlefshme për zgjedhjet për kryetar komune ishin mjaft më të ulëta, me 3.0% (me 1% nga to që ishin të zbrazëta). Megjithatë, pavlefshmëria prej 3% do



të thotë që 15,512 votues hodhën vota të pavlefshme, 8,248 hodhën vota të zbrazëta dhe 1,080 hodhën vota të dëmtuara. Në vend që të shihet një përmirësim i vlefshmërisë së votave, trendi është negativ në krahasim me zgjedhjet e vitit 2010 por edhe me zgjedhjet e vitit 2009, kur votat e pavlershme ishin në nivelin më të lartë.

## VII. Rekomandimet

Rekomandimet e poshtëshënuara rrjedhin nga analiza e ofruar më lart dhe nga përvoja që Demokracia në Veprim ka marrë duke vëzhguar dhe raportuar vazhdimisht mbi procesin zgjedhor në Kosovë. Secili rekomandim është i bazuar në një nga përfundimet që del nga raporti më lartë.

### A. Komisioni Qendror Zgjedhor

- Fushata e informimit votues duhet të bazohet në një anketë paraprake me votuesit dhe hulumtim të thuktë që të mund të targetoj dhe përshtatet grupeve që kanë nevojë më së shumti për ato informata, sikurse votuesit e rinj dhe femrat. KQZ duhet të përqendroj fushatën informues në mbushjen e fletëvotimeve të zgjedhjeve që organizon që të parandaloj nivelin e lartë të votave të pavlefshme, si dhe ta përqendroj atë në mekanizmat e ankesave dhe parashtrësive që të bëjë qytetarët më të informuar për sigurimin e procesit zgjedhor të rregullt;
- Qasja e azhurnimit të Listës së Votuesve duhet të ndryshojë pasiqë përpjekjet e deritanishme nuk kanë funksionuar në masë të madhe. KQZ ka nevojë të rishikoj sistemin e P-kodeve dhe UD-kodeve për përcaktimin e qendrës së votimit për votues dhe duhet të ofroj një mekanizëm për votuesit që nuk gjejnë emrin në qendrën ku ata që vijnë në ditë të zgjedhjeve të mund të përmirësojnë të dhënat e tyre po aty;
- Rezultatet e zgjedhjeve për kuvende komunale nuk duhet të tejzgjaten dhe duhet të publikohen para zgjedhjeve të balotazhit. Në këtë cikël zgjedhor, rezultatet për kuvende komunale u publikuan saktësisht një muaj pas ditës së zgjedhjeve, vetëm pasi votimi për balotazh përfundoj. Kjo sjell dyshime dhe ankth tek kandidatët dhe votuesit;
- Fletëvotimet, që konsiderohen si të pavlefshme, nuk duhet të shkatërrohen pa u hulumtuar mirë arsyt kryesore për pavlefshmërinë e tyre. Një raport duhet të përpilohet mbi këtë hulumtim me qëllim që KQZ por edhe shoqëria civile të kenë një bazë më të mirë për përshtatjen e aktiviteteve të edukimit votues;
- Komisionerët e Vendvotimeve duhet të trajnohen më mirë për të ngritur efikasitetin e procesit të numërimit, siç thërret edhe legjislacioni në fuqi, dhe të mënjanojnë tejzgjatjet e procesit të numërimit deri në katër apo pesë orë siç ka ndodhur në gati gjysmën e vendvotimeve;

- Udhëzime të qarta dhe konsistente, në koordinim me PZAP, duhet tu ipen KVV-ve mbi fotografimin e fletëvotimit nga votuesit dhe kjo duhet të përfshihet si një nga elementet e fushatës të edukimit të votuesve.

## B. Komisionet Komunale Zgjedhore

- Duhet të ketë takime formale, të rregullta që mbahen gjatë gjithë procesit zgjedhor në mënyrë që çështjet organizative të zgjedhjeve të diskutohen siç parashihet me ligj dhe vendimet të merren në formë zyrtare;
- KKZ-të duhet të jenë transparente ndaj vëzhguesve të organizatave jo-qeveritare duke ofruar rendin e ditës të takimeve dhe vendimet. Duke mbajtur takime formale, KKZ-të do të ishin më përgjegjëse dhe transparente ndaj qytetarëve dhe veçanërisht vëzhguesve të shoqërisë civile;
- KKZ-të duhet të dalin në terren dy ditë para ditës së zgjedhjeve dhe të shënojnë gjitha materialet e fushatës (billborde dhe posterë) brenda diametrit të 100 metrave nga qendresa së votimit dhe të përkujtojnë subjektet politike që të tërheqin materialet 24 orë përpara se procesi i votimit të filloj. Siç tregojnë të dhënat tona të ditës së zgjedhjeve, 4.5% e qendrave të votimit kanë pasur propagandë zgjedhore brenda diametrit prej 100 metrave;
- Të bëjnë përpjekje më të madhe për edukimit të votuesve dhe pastrimit të listës së votueseve veçanërisht kur gjendemi jashtë periudhës procesit të zgjedhjeve.

## C. Komisionet e Vendvotimeve

- Komisionerët duhet të jenë shumë më vigjilent për parandalimin e votimit familjar pasi që një gjë e tillë vazhdon të cenoj fshehtësinë e votimit;
- Votimi me asistencë është mirë i rregulluar dhe komisionerët nuk duhet të tolerojnë asnjë tentim që një person të asistojë më shumë se një votues siç është toleruar në disa vendvotime që ceken në këtë raport;
- Keqbërësit që tentojnë të manipulojnë procesin zgjedhor dhe votojnë për së dyti herë, siç janë identifikuar disa raste, duhet të raportohen tek autoritetet e sigurimit dhe të ndërtohet një rast kundër tyre dhe jo vetëm të ndalohen dhe kthehen pa asnjë ndëshkim;
- Zbatimi i vendimeve të KQZ-së për fotografimin e fletëvotimit duhet të jetë strikt dhe të mos tolerohen përjashtime;

- Menaxherët e qendrave të votimit të mos lejohen të ndërhyjnë në numërimin e fletëvotimeve apo edhe të kundërshtojnë rezultatin në vendvotim pasi që nuk kanë kompetencë për këtë.

## D. Subjektet Politike

- Të bëjnë përpjekje për të emëruar numër më të madh të femrave në Komisionet e Vendvotimeve pasi që niveli i tanishëm është shumë i ulët ndërsa përfaqësimi gjinor është sidomos i ulët në disa komuna më të vogla;
- Grupe të organizuara të fëmijëve dhe shërbyesve civil nuk duhet të lejohen në tubime të fushatave;
- Zyrtarët publik nuk duhet të përdorin resurset publike në fushatë zgjedhore pasi që e bënë fushatën të pabarabartë dhe dëmton taksapaguesit kosovar;
- Udhëzohet degët lokale të mobilizohet mirë për tërheqjen e propagandës politike brenda dhe jashtë qendrave të votimit;
- Kur të përgatisin ankesat, subjektet politike, por edhe OJQ-të, duhet të jenë të vetëdijshme për kriteret e PZAP-së për ankesa dhe elementet që determinojnë aprovimin e një ankese. PZAP ka kriteret strikte për aprovimin e ankesave dhe shpesh ankesat refuzohen si shkak i mos njohjes së këtyre kriterëve nga subjektet politike;
- Gjatë konsultimeve me Presidentin, subjektet politike duhet të kenë parasysh që caktimi i datës së zgjedhjeve të anashkaloj ditët e ftohta të dimrit. Dita e Zgjedhjeve duhet të shpallet në një kohë kur moti do të duhej të ishte i përshtatshëm për votim, dhe jo në nëntor apo dhjetor siç është bërë zakon në Kosovë. Planifikimi i ditës zgjedhore në ditë të ngrohta dhe kur dielli perëndon më vonë, do të siguronte që dalja në votim të rritej edhe në orët e mëngjesit që po karakterizohet me dalje të ulët por edhe të jetë në kohën kur diaspora të jetë në Kosovë.

## E. Mekanizmat e Ankesave

- PZAP duhet të rris numrin e paneleve për zgjedhjet e kuvendeve komunale, respektivisht zgjedhjeve lokale, pasi që garojnë numër shumë më i madh i kandidatëve se për zgjedhjet e përgjithshme dhe sigurojnë që edhe numri i ankesave dhe parashtrësive pritet të jetë më i madh. Kjo do të siguronte që PZAP të shqyrtojë më me kujdes ankesat dhe parashtrësit dhe të mos jep vendime në mënyrë të shablloneve dhe që nuk japin arsyetime të mjaftueshme për vendimin, sidomos kur ankesa refuzohet;

- PZAP duhet të informoj KQZ-në mbi rastet që presin vendimin e tyre, veçanërisht për rastet që mund të kenë ndikim në obligimet ligjore të KQZ-së, si finalizimi i Listës së Votuesve apo edhe rasteve që mund të ndikojnë në rezultatet finale të vendvotimeve. Duhet të ketë një mekanizëm të koordinimit gjatë procesit zgjedhor në mes të KQZ, PZAP dhe Gjykatës Supreme në mënyrë që të gjitha palët të jenë të informuara për punën e njëra-tjetrës gjatë procesit zgjedhor.

## F. Kuvendi i Kosovës

- Ndryshojë Nenin 7.5 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale që merr votën për subjektin politik si votë edhe për prijësin e listës së kandidatëve të atij subjekti;
- Të shqyrtoj në reformë zgjedhore regjistrimin aktiv të votuesve në rast se KQZ dhe MPB nuk janë të afta të përmirësojnë në mënyrë rrënjësore Listën e Votuesve;
- Parashih përfshirjen gjinore në emërimin e anëtarëve të KVV-ve, pasiqë, në masë të madhe gratë janë lënë jashtë trupave të administrimit të zgjedhjeve;
- Ndalojë me ligj fotografimin e fletëvotimit nga votuesit pasiqë ka indikacione që po përdoret për blerje të votave dhe mos ta lejojë këtë çështje të rregullohet nga KQZ apo PZAP që mund të dërgojnë edhe mesazhe të kundërta në mungesë të një dispozite të saktë ligjore.



Përkrahur nga:



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



British Embassy  
Pristina



NORWEGIAN EMBASSY